Drejtori eshte emeruar nga Keshilli Mbikqyres dhe eshte person fizik per nje periudhe tre vjecare dhe mund te rimerohet. Si emerimi dhe shkarkimi i tij eshte kompetence e Keshillit Mbikqyres, por gjithmone shkarkimi behet per shkaqe te perligjura.
Kontraten e punes me drejtorin e shoqerise e lidh ne emer te saj kryetari i Keshillit Mbikqyres. Ne te fiksohet menyra dhe masa e shperblimit te tij.

KOMPETENCAT E DREJTORISE DHE MARRJA E VENDIMEVE PREJ SAJ

NENI 14

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo i ushtron keto kompetenca brenda objektit te veprimtarise se shoqerise, por kufizohet ne ato kompetenca qe ligji per shoqerite tregtare ja jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

Drejtori shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne kete statut.
Drejtori raporton per veprimtarine e tij dhe pergjigjet para Keshillit Mbikqyres per realizimin e qellimeve dhe angazhimeve qe jane ne kompetence te tij.
Drejtori perfaqeson shoqerine perpara te treteve, ne gjykata dhe arbitrazhe, administron pasurine dhe interesat e saj me perjashtim te kompetencave qe ju takojne organeve te tjere te shoqerise.
Klauzolat e statutit qe kufizojne kompetencat e drejtorit duhet te respektohen nga te tretet.
Drejtori mund te marri angazhime deri ne ate mase qe te mos kaloje vlera e 30% te kapitalit themeltar, ne te kundert duhet te marre autorizim nga kryetari i Keshillit Mbikqyres.
Eshte ne kompetence te drejtorit, te marre vendime per:
- Nivelin e punesimit dhe pagave.
- Rregulloren e drejtorise dhe rregulloren organizative te shoqerise.
- Kushtet social jetesore te punonjesve.

Te gjitha vendimet e drejtorise, protokollohen dhe nenshkruhen prej tij.

## KESHILLI MBIKQYRES
## NENI 15

## KOMPETENCAT

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll ndaj drejtorise per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Perfundimi i operacioneve te parashikuara ne statut qe jane kompetence e Keshillit Mbikqyres, mund te behet vetem me autorizimin paraprak te Keshillit Mbikqyres.
Tejkalimi i kompetencave te ketij autorizimi duhet te respektohet nga te tretet qe nuk kane pasur dijeni per te.
Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryej ne çdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ai i gjykon te nevojshme dhe te kerkoj te njihet me dokumentat per plotesimin e detyres se tij.
Drejtoria i paraqet raport Keshillit Mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.
Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar drejtoria i paraqet Keshillit Mbikqyres dokumentet e llogarise vjetore dhe ne rast se eshte e nevojshme çdo lloj dokumenti me qellim verifikimi dhe kontrolli.
Keshilli Mbikqyres i paraqet Asamblese se Aksionereve ne mbledhjen vjetore verejtjet e tij mbi raportin e drejtorise si dhe ato mbi llogarite e vitit financiar.
Mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, e therret kryetari i keshillit ne keto raste:
- me inisiativen e vet,
- me propozim me shkrim te nje antari te Keshillit Mbikqyres,
- me propozim me shkrim te drejtorit.

Mbledhja duhet thirrur brenda 30 diteve nga momenti i paraqitjes se propozimit. Keshilli Mbikqyres miraton rregulloren e tij e cila trajton me hollesi menyren e veprimit.

Keshilli Mbikqyres delegon antaret e tij per kryerjen e perkohshme te detyrave te drejtorise se shoqerise kur ajo per arsye te ndryshme nuk funksionon.

PERBERJA

NENI 16

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 antare. Asnje anëtar i Keshillit Mbikqyres nuk mund te jete anëtar i drejtorise.

NENI 17

Anëtaret e pare te Keshillit Mbikqyres u caktuan ne statut nga une themeluesi i shoqerise.
Konkretisht ata jane:

1. Rovena Karcini (kryetare)
2. Ilir Kotini
3. Artan Serjani.

.Ekspert Kontabel emerohet Leze Abazi
Antaret e pare te Keshillit Mbikqyres dhe eksperti i pare kontabel caktohen per nje afat tre vjet.
Mbas perfundimit te afatit te antareve te pare te Keshillit Mbikqyres dhe ekspertit kontabel te autorizuar te caktuar ne statut emerimi dhe zgjedhja e radhes e tyre behet ne perputhje me nenet e meposhtme.

NENI 18

Me mbarimin e afatit antaret mund te zgjidhen nga Asambleja e Aksionereve, po keshtu ata mund te shkarkohen ne çdo moment nga Asambleja e zakonshme e aksionereve per shkaqe te perligjura.
Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga vdekja apo doreheqja e njërit ose disa antareve te Keshillit Mbikqyres, ky keshill mundet ne periudhen ndermjet dy mbledhjeve te Asamblese te beje zgjedhje te perkohshme.
Kur numri i antareve te Keshillit Mbikqyres ka zbritur nen minimumin ligjor, drejtoria duhet te therras urgjentisht mbledhjen e Asamblese se zakonshme per te plotesuar organiken e Keshillit Mbikqyres.

NENI 19

Per vleshmerine e vendimeve te Keshillit Mbikqyres, kerkohet qe te ftohen ne mbledhje gjithe antaret e tij dhe te jene te pranishem mbi 50 %.
Keshilli Mbikqyres merr vendime me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem, ose te perfaqesuesve te tyre me perjashtim te ceshtjeve te meposhtme, per te cilat kerkohet jo me pak se tre te katertat e votave:

- Dhenia dhe marrja e kredive me leke dhe valute te huaj.
- Lidhja e kontratave me vlere me te madhe se 30 % e kapitalit themeltar

- Miratimi i autorizimit per krijimin e filialeve dhe degeve te reja te shoqerise
- Emerimin e drejtorit

Vota e kryetarit eshte percaktuese ne rast rezultati te barabarte.
Shperblimi i antareve te Keshillit Mbikqyres perballohet nga llogaria e shoqerise.

NENI 20

Anëtaret e drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres si dhe çdo person qe thirret te marre pjese ne mbledhjet e ketyre organeve, duhet te ruaje fshehtesine per te dhenat qe kane karakter te brendshem dhe qe cilesohen si te tilla nga kryetari.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

NENI 21

Vetem Asambleja e Jashtezakonshme ka kompetenca te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij.
Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 1/2 e aksioneve dhe ne te dyten 1/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne te kundert, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date te me voneshme jo me larg se 2 muaj nga data e thirrjes se mbledhjes se pare. Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime me nje shumice votash prej 3/4 qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

NENI 22

Asambleja e Zakonshme merr çdo vendim pervec atyre qe permenden ne nenin 21. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem ne qofte se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 1/4 e aksioneve. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi.
Asambleja e Zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.
Te drejten per te marre pjese ne mbledhjen e asamblese e kane aksioneret, çdo aksion eshte i barabarte me nje vote.

NENI 23

Asambleja e Zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Per thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes zbatohen rregullat e percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare.

KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 24

Ne shoqeri kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar. Eksperti kontabel i autorizuar emerohet nga Asambleja e aksionereve e zakonshme. Shoqeria ka te drejtë te emerojë një ose disa prej tyre.
Ne çdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose veç e veç bejne te gjitha verifikimet e kontrollit qe i gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre dhe ne veçanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proçes verbalet.
Eksperti kontabel i bene te njohur drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres :
- Kontrollet dhe verifikimet qe ka kryer.
- Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje,
- Parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.
Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e drejtorise kur mbyllen llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per faj dhe nenvleftesim te tyre ne ushtrimin e funksioneve qe kane.
Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise.
Asambleja me rastin e emerimit cakton dhe madhesine e shperblimit.

USHTRIMI FINANCIAR

NENI 25

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar fillon nga data e regjistrimit person juridik te shoqerise deri ne 31 dhjetor te atij viti.

INVENTARI, LLOGARITE VJETORE

NENI 26

Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt ne pajtim me ligjin.
Ne mbyllje te çdo ushtrimi financiar, drejtoria harton iventarin e elementeve te ndryshem te aktivit dhe te pasivit ne kete date si dhe llogarite vjetore te shoqerise.
Drejtoria harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e ardhshme te parashikuara, ngjarjet e ndodhura midis dates kur eshte hartuar raporti dhe veprimet e kerkimit te zhvillimit.

## SHKAQET E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

### NENI 27

Shoqeria shperndahet:
- Me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme.
- Kur shoqeria falimenton.
- Ne çdo menyre te parshikuar ne ligj.

Grumbullimi i te gjitha aksioneve ne nje person, nuk perben shkak per shperndarjen e shoqerise.

## LIKUJDIMI

### NENI 28

Per likujdimin e shoqerise zbatohen rregullat e percaktuara ne ligjin "Per Shoqerite Tregtare". Asambleja e Jashtezakonshme cakton likujdatoret duke u percaktuar dhe fuqite qe ata kane.

## RAPORTET VJETORE

### NENI 29

Ne fund te çdo viti financiar, drejtoria bene inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin te cilat se bashku me bilancin ia paraqet asamblese per shqyrtim.
Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar pasi te jene zbritur po qe se ka humbjet e vitit te meparshem, heq menjane një shume te pakten 8 % te fitimit neto e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur rezerve e domosdoshme. Çdo vendim i kundert eshte i pavleshem. Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/3 e kapitalit themeltar.

### NENI 30

Asambleja e Zakonshme ne rast nevoje, mund te formoje fonde te tjera perveç fondit te caktuar ne nenin 29 te ketij statuti. Pas plotesimit te shumes te fondeve te mesiperme pjesa e mbetur e fitimit caktohet per ndarje per aksioneret ne varesi me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

### NENI 31

Mardheniet e shoqerise me sindikatat rregullohen sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise. Per te punesuarit do te zbatohen dispozitat ligjore qe normojne mardheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

NENI 32

Çdo mosmarreveshje qe mund te lindi midis paleve do te zgjidhet ne rruge mirekuptimi dhe ne rast se nje mosmarreveshje e tille nuk zgjidhet me mirekuptim palet kane te drejte ti drejtohen gjykates Shkalles se Pare Tirane.

NENI 33

Te gjitha çeshtjet qe nuk permenden ne kete statut dhe qe kane te bejne me shoqerine rregullohen sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare.
Statuti u hartua ne kater kopje ne gjuhen shqipe, te gjitha me fuqi te njejte ligjore.

AKSIONERI

**STATUT**

**I**

**FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE**

**NENI 1- EMERTIMI, SELIA DHE OBJEKTI**

Emri i kesaj shoqate eshte FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERMARRJEVE (Shoqata)

1.2. Selia

Selia e Shoqates do te jete ne New York, New York. Zyra te tjera qe mund t'i nevojiten aktivitetit te shoqates do te vendosen ne ate vende ose vende, si brenda ashtu dhe jashte shtetit Delaware, sic mund te vendoset nga Bordi i Drejtoreve.

1.3. Objekti.

Sic eshte parashikuar ne Aktin e Themelimit, objekti i shoqates do te jete (i) te promovoje zhvillimin e sektorit privat te Shqiperise me pikesynim biznesin e vogel e te mesem privat, ortakerite midis pjesemarresve nga Shtetet e Bashkuara dhe Shqiperia dhe politikat dhe praktikat e nevojshme per zhvillimin e sektorit privat ne Shqiperi nepermjet huave, granteve, investimeve, studimeve potenciale, asistence teknike, sigurim, garanci dhe masa te tjera (ii) te zhvilloje te gjitha qellimet dhe politikat dhe te bashkerendohet me Ndihmen per Demokracite e Europes Juglindore te 1989 (Dokumenti "SEED") ashtu sic mund te ndryshohet. Bordi i Drejtoreve eshte i autorizuar te adoptoje rregulla te tjera, rregullore dhe politika qe mund te jene te nevojshme per te zhvilluar objektin e shoqates, per te vepruar ne perputhje me Dokumentin SEED, per te krijuar sisteme llogarish dhe kontrolle financiare qe jane ne perputhje me principet e pergjithshme te pranuara kontabile dhe jane ne menyre te arsyeshme te nevojshem per te siguruar qe fondet e shoqates te mos jene subjekt i shperdorimeve, shkeljeve dhe abuzimeve dhe per te siguruar qe aktiviteti i biznesit te shoqates, perfshire pa u kufizuar, sigurimin e fondeve te marra nga shoqata para perdorimit te tyre, do te perdoren ne menyre te arsyeshme. Shoqata nuk do te ndermarre asnje aktivitet qe nuk lejohet te zhvillohet nga Dokumenti SEED ose nga nje shoqate e perjashtuar nga taksat federale sipas Seksionit 501 (c) (3) i Kodit te te Ardhurave te Brendshme te 1986, i modifikuar ose parashikimeve korresponduese te cdo ligji te ardhshem federal mbi taksat (Kodi).

**NENI 2- ANETARET**

2.1 Mbledhja vjetore.

Te gjithe anetaret e shoqates (ne njejes Anetar dhe shumes Anetaret) do te mblidhen ne nje mbledhje vjetore per zgjedhjen e drejtoreve dhe per kryerjen e transaksioneve te cdo lloj biznesi tjeter qe mund te ndodhe para mbledhjes, ne te enjten e trete te janarit te cdo viti ne ate vend dhe kohe, brenda ose jashte shtetit te Delaware qe mund te vendose Bordi i Drejtoreve nepermjet vendimit ose ne ate kohe dhe vend qe jane fiksuar nga vendimi i Bordit te Drejtoreve jo me pak se 30 (tridhjete) dite para dates se mbledhjes.

2.2 Mbledhjet e vecanta

Mbledhjet e vecanta te Anetareve mund te thirren nga Kryetari ose Zevendeskryetari (ashtu sic keto terma jane percaktuar ketu me poshte) dhe mund te thirren nga Kryetari ose Zevendeskryetari me kerkesen e drejtoreve qe perbejne nje shumice brenda gjithe Bordit te Drejtoreve ose me kerkesen e shumices se Anetareve. Shprehja "I gjithe Bordi i Drejtoreve" ne kete Statut i referohet numrit te pergjithshem te drejtoreve qe shoqata do te kishte nese nuk do te kishte vende bosh.

2.3 Njoftimi ose heqja dore nga njoftimi

Njoftimi i shkruar per te gjitha mbledhjet e Anetareve do te behet duke fiksuar vendin, daten dhe oren e takimit. Njoftimi i nje mbledhjeje te vecante ne te gjitha rastet do te percaktoje qellimin ose qellimet per te cilat mbledhja do te thirret. Si perjashtim ose nese percaktohet ndryshe ne Ligjin e pergjithshem te Shoqatave te Shtetit Delaware ose te cdo amendamenti tjeter (GCL) njoftimi i shkruar i cdo mbledhjeje do te behet personalisht ose me poste jo me pak se 10 (dhjete) dite dhe jo me shume se 60 (gjashtedhjete) dite para dates se mbledhjes perndryshe nga periudha e pershkruar per njoftim do tehiqet dore. Njoftimi me poste do te konsiderohet i bere pasi te jete depozituar, me poste te parapergatitur, ne posten e Shteteve te Bashkuara drejtuar Anetarit ne adresen e tij te regjistruar ose ne ate adrese qe mund t'i jete paraqitur me shkrim Sekretarise se shoqates. Nese nje mbledhje eshte shtyre per nje kohe tjeter jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga dita e kesaj shtyrjeje,dhe/ose ne nje vend tjeter dhe nese njoftimi i kohes dhe vendit te shtyrjes eshte bere ne mbledhje, nuk do te jete e nevojshme per te bere njoftim per mbledhjen e shtyre vetem nese Bordi i Drejtoreve pas shtyrjes vendos nje date te re per mbledhjen e shtyre. Nuk kerkohet qe njoftimi t'i behet atij Anetari i cili paraqet nje doreheqje te shkruar ose nje njoftim te firmosur nga ai si perpara ashtu dhe pas kohes se fiksuar atje. Prezenca e nje Anetari ne nje mbledhje do te perbeje nje heqje dore nga njoftimi i kesaj mbledhjeje pervecse kur Anetari merr pjese ne mbledhje per qellimin e shprehur ne fillim te mbledhjes per kundershtimin e kryerjes se transaksionit te cdo biznesi sepse mbledhja nuk eshte thirrur ose mbledhur ne menyre te ligjshme. Si biznesi qe do te kryhet, edhe qellimi i cdo mbledhje te zakonshme ose te veçante e Anetareve nevojitet te specifikohet ne nje heqje dore nga njoftimi.

2.4 Kuorumi

Pervec kur eshte parashikuar ndryshe ne ligj, Akti i Themelimit ose ky Statut, prezenca, personalisht ose me zevendesues, i shumices se Anetareve do te perbeje kuorum per kryerjen e transaksioneve te biznesit ne cdo mbledhje te anetareve. Nje shumice e Anetareve te pranishem, qofte ose jo kuorum i pranishem, mund te shtyje mbledhjen e Anetareve.

2.5 Menyra e veprimit

Pervec kur eshte parashikuar ndryshe ne ligj, Akti i Themelimit ose ky Statut, Anetaret do te kene te drejten e nje vote ne te gjitha ceshtjet e paraqitura atyre. Kur kuorumi eshte i pranishem ne cdo mbledhje te Anetareve, vota e shumices se Anetareve te paraqitur ne mbledhje, personalisht ose me perfaqesues, do te vendose mbi cdo ceshtje te votuar nga Anetaret ne kete mbledhje, pervec kur nje vote e ndryshme kerkohet nga parashikimi i shprehur i ligjit, Aktit te Themelimit ose ky Statut. Ne zgjedhjen e drejtoreve dhe per cdo veprim tjeter votimi nuk nevojitet te behet me shkrim.

Veprimi i Anetareve pa u mbledhur

Cdo veprim qe kerkohet te ndermerret ne cdo mbledhje te Anetareve nga GCL ose cdo veprim i cili mund te merret ne cdo mbledhje te Anetareve mund te merert pa u mbledhur, pa njoftim paraprak dhe pa u votuar nese miratimi ose miratimet me shkrim, qe percakton veprimin qe do te merret, do te nenshkruhet nga Anetaret qe perbejne jo me pak se minimumi i numrit te votave qe do te ishin te nevojshme per te autorizuar ose ndermarre ate veprim ne nje mbledhje ne te cilen te gjithe Anetaret me te drejte vote ishin te pranishem she votojne dhe do t'i dergoeht shoqates duke e shperndare ne seline e saj ne shtetin Delaware, ne vendin kryesor te veprimtarise ose nepunesit ose agjentit te shoqates qe merret me librat ne te cilat procedimi i mbledhjeve te Anetareve jane regjistruar. Dergesa e bere per ne seline e shoqates do te behet me dore ose me poste te regjistruar me kthim pergjigje marrjeje. Cdo miratim i shkruar duhet te kete daten e nenshkrimit te cdo Anetari qe nenshkruan miratimin dhe asnje miratim nuk do te jete efektiv per te marre veprimin e shoqates se referuar ketu, te pakten 60 (gjashtedhjete) dite nga dita kur miratimi me i hershem i eshte derguar shoqates ne menyren e pershkruar nga GCL, miratimet me shkrim te nenshkruara nga nje numer i mjaftueshem Anetaresh per te marre ate veprim i jane shperndare shoqates ne menyren e percaktuar me lart. Njoftimi i menjehershem i veprimit nga Anetaret, pa u mbledhur nga me pak se te gjithe miratimet e shkruara do t'u jepet atyre anetareve qe nuk kane miratuar me shkrim.

## NENI 3 BORDI I DREJTOREVE

3.1 Drejtimi

Pervec kur eshte parashikuar ndryshe ne Aktin e Themelimit, biznesi, pasuria dhe punet e shoqates do te drejtohen nga ose nen drejtimin e Bordit te Drejtoreve. Kualifikimet, zgjedhja, numri, kompetencat dhe detyrat e drejtoreve do te sic jane parashikuar ne Aktin e Themelimit.

3.2 Mbledhja vjetore

Mbledhja vjetore e Bordit te Drejtoreve per zgjedhjen e cdo nepunesi dhe per kryerjen e transaksioneve te cdo biznesi qe mund te behet para mbledhjes do te mbahet menjehere pas mbledhjes vjetore te Anetareve ne ate vend, brenda ose jashte shtetit Delaware qe Bordi i Drejtoreve ka vendosur me vendim ose brenda 60 (gjashtedhjete) ditesh pas mbledhjes vjetore te Anetareve ne kohen dhe vendin e fiksuar me vendim te Bordit te Drejtoreve te marre jo me pak se 30 (tridhjete) dite para dates se mbledhjes.

3.3 Mbledhjet e jashtezakonshme

Mbledhjet e jashtezakonshme te Bordit te Drejtoreve mund te thirren nga Kryetari ose Zevendeskryetari (ashtu sic jane percaktuar keto terma ketu) dhe mund te thirren nga Kryetari ose Zevendeskryetari me kerkesen e drejtoreve qe perbejne nje shumice te te gjithe drejtoreve.

3.4 Njoftimi ose heqja dore nga njoftimi

Nuk kerkohet asnje njoftim per mbledhjet e zakonshme per te cilat koha dhe vendi eshte vendosur nepermjet vendimit te Bordit te Drejtoreve. Njoftimi i shkruar per cdo mbledhje te jashtezakonshme te Bordit te Drejtoreve do te behet te pakten 10 (dhjete) dite para dates se mbledhjes dhe mund te specifikoje kohen dhe vendin per ate mbledhje por nuk eshte e nevojshme te specifikoje qellimin e kesaj mbledhjeje. Ky njoftim do t'i dergohet personalisht ose do t'i dergohet me poste ose me telegram ose faks secilit

drejtor ne adresat e drejtoreve te treguara ne regjistrat e shoqates. Nese postohet, ky njoftim do te konsiderohet i derguar kur depozitohet ne posten e Shteteve te Bashkuara ne nje zarf me vule te adresuar, me postage te parapergatitur. Nese njoftimi behet me telegram, ky njoftim do te konsiderohet i derguar nese telegrami i eshte derguar kompanise telegrafike. Nese njoftimi behet me faks, ky njoftim do te konsiderohet i derguar kur faksi eshte derguar ne numrin e marresit te treguar nga drejtori. Drejtoret mund te heqin dore nga njoftimi i mbledhjes pervec kur nje drejtor merr pjese ne mbledhje per te shprehur ne fillim te mbledhjes, kundershtimin per kryerjen e transaksionit te cdo biznesi sepse mbledhja eshte thirrur ose mbledhur ne menyre te paligjshme.

3.5 Kuorumi

Prezenca personalisht e drejtoreve qe perbejne te pakten nje te treten e numrit te pergjithshem te drejtoreve do te perbeje kuorumin per transaksionet e biznesit ne cdo mbledhje te Bordit te Drejtoreve. Ky seksion 3.5 nuk do te zbatohet per plotesimin e vendeve bosh te Bordit te Drejtoreve, ose anullimin nese nje zbatim i tille mund te parandaloje keto vende bosh nga plotesimi ose anullimi. Shumica e pranishme e Bordit te Drejtoreve, qofte ose jo nje kuorum i pranishem, mund te shtyje mbledhjen e Bordit te Drejtoreve.

3.6 Menyra e veprimit

Pervec sa eshte parashikuar ketu, ne Aktin e Themelimit ose ne GCL ne nje mbledhje ne te cilen eshte e pranishme kuorumi i Bordit te Drejtoreve, vota e shumices se (i) drejtoreve te pranishem ne ate mbledhje dhe (ii) Drejtoret e Shteteve te Bashkuara (ashtu si ky term eshte percaktuar ne Aktin e Themelimit) te pranishem ne mbledhje, do te perbeje nje dokument te Bordit te Drejtoreve.

3.7 Nepunesit e Bordit te Drejtoreve

Bordi i Drejtoreve, ne nje nga menyrat e parashikuara ketu, do te zgjedhe nje Kryetar te Bordit te Drejtoreve (Kryetari) dhe mund te zgjedhe nje Zevendeskryetar te Bordit te Drejtoreve (Zevendeskryetari) si nepunes te Bordit te Drejtoreve. Per qellimet e ketij Statuti cdo reference tek termi Zevendeskryetar do te zbatohet nese Bordi i Drejtoreve ka zgjedhur nje Zevendeskryetar. Do te jete detyre e Kryetarit te drejtoje te gjitha mbledhjet e Bordit te Drejtoreve, te paraqese rekomandimet qe Kryetari mund t'i konsideroje te pershtatshme ne lidhje me biznesin dhe veprimtarine e shoqates dhe te kryeje detyra te tjera qe mund te jene percaktuar ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut ose mund te jene percaktuar nga Bordi i Drejtoreve. Ne mungese ose pamundesi te Kryetarit, Zevendeskryetari do te ushtroje kompetencat dhe do te realizoje detyrat e Kryetarit. Zevendeskryetari gjithashtu do te ushtroje ato kompetenca te tjera dhe do te kryeje ato detyra te tjera sic mund te jene percaktuar nga Bordi i Drejtoreve. Ne mungese ose pamundesi te Kryetarit dhe te Zevendeskryetarit, Bordi i Drejtoreve mund te zgjedhe nje Kryetar te Perkohshem nga anetaret e tij per te kryer detyrat e Kryetarit deri ne ate kohe si nje Kryetar ose Zevendeskryetar i perkohshem, sic mund te jete rasti, eshte zgjedhur ose pamundesia e Kryetarit ose Zevendeskryetarit ekzistues, sic mund te jete rasti, eshte zevendesuar.

Kryetari i pare do te jete Domenick G. Scaglione, i cili do te jete ne kete pozicion derisa nje mbledhje e Bordit te Drejtoreve te mblidhet jo me vone se 28 Prill 1995, ne te cilen Bordi i Drejtoreve do te zgjedhe nje Kryetar dhe mund te zgjedhe nje Zevendeskryetar ne perputhje me kete Statut, i cili do te sherbeje deri ne fund te mbledhjes vjetore te vitit 1998. Me perjashtim te Domenick G. Scaglione, Kryetari do te

zgjidhet me keshillen e Presidentit te Shteteve te Bashkuara ose te emeruarin e tij (ketu e me poshte i quajtur Presidenti i Shteteve te Bashkuara), keshille e cila duhet te kerkohet nga Kryetari i momentit, Zevendeskryetari (ne rast mungese ose pamundesie te Kryetarit) oser Kryetari i perkohshem ne rast mungese ose pamundesie te Kryetarit dhe Zevendeskryetarit), jo me vone se 30 (tridhjete) dite para kesaj zgjedhjeje. Kryetari dhe Zevendeskryetari i zgjedhur do te sherbejne si nepunes te Bordit te Drejtoreve deri ne fund te mbledhjes se trete te Bordit te Drejtoreve qe vijon pas zgjedhjes perkatese, ose deri ne doreheqjen ose zevendesimin e tyre me te shpejte, ne kohen ne te cilen Bordi i Drejtoreve do te zgjedhe a Kryetar ose Zevendeskryetar tjeter, sic mund te jete rasti.

3.8 Agjentet, financieret dhe avokatet
Bordi i Drejtoreve do te punesoje agjente, financiere dhe avokate sic do te jete e nevojshme per te ndihmuar Bordin e Drejtoreve duke iu shkarkuar detyrimet e tij dhe plotesuar detyrat e tij te besuara.

3.9 Doreheqja
Nje drejtor mund te jape doreheqjen ne cdo kohe duke i dhene njoftim me shkrim Bordit te Drejtoreve. Vetem nese percaktohet ndryshe ne njoftim, doreheqja do te kete pasoja me marrjen e saj nga Bordi i Drejtoreve dhe pranimi i doreheqjes nuk eshte i nevojshem per ta bere ate te efektshem.

3.10 Delegimi tek Komitetet
Me rekomandimin e Kryetarit, Bordi i Drejtoreve, nepermjet vendimit te marre nga drejtoret qe perbejne shumicen e gjithe Bordit te Drejtoreve mund (i) te zgjedhe ose themeloje cdo Komitet special per ato qellime dhe me ato kompetenca dhe kushte sic jane percaktuar ne ate vendim, (ii) te beje delegimin e kompetencave Kryetarit ose Zevendeskryetarit ose nepunesve te shoqates sic mund te jete e nevojshme per te zhvilluar punet e shoqates, dhe (iii) te caktoje numrin dhe perberjen e cdo komiteti. Pervec sa mund te jete parashikuar ndryshe ne ligj, keto delegime do te behen per qellime dhe me ato kompetenca dhe kushte sic jane percaktuar ne ate vendim.

3.11 Shperblimi i drejtoreve
Ne perputhje me dokumentin SEED dhe objekt i Seksionit 501 (c) (3) te Kodit, drejtoret kane te drejten e nje shperblimi te arsyeshem per sherbimet e tyre dhe pagesen ose rimbursimin e shpenzimeve qe vijne ne lidhje me keto sherbime. Ky shperblim do te vendoset nga Bordi i Drejtoreve. Bordi i Drejtoreve mund te vendose te shperbleje drejtoret shqiptare dhe drejtoret e jo Shteteve te Bashkuara.

3.12 Veprimi me miratim
Cdo veprim i kerkuar qe te ndermerret ose qe mund te ndermerret nga Bordi i Drejtoreve ose cdo komitet mund te behet pa nje mbledhje nese te gjithe anetaret e Bordit te Drejtoreve ose nje komitet, sipas rastit, miraton me shkrim, dhe miratimi ose miratimet jane regjistruar ne procesverbalet e Bordit te Drejtoreve ose te Komitetit, sipas rastit.

3.13 Mbledhje nepermjet telefonit dhe mjeteve te tjera te komunikimit te ngjashme
Anetaret e Bordit te Drejtoreve ose cdo komitet i tille, mund te marre pjese ne mbledhjen e Bordit te Drejtoreve ose te Komitetit, sipas rastit, ne kuptimin qe te gjithe personat pjesemarres mund te degjojne ose te flasin me njeri-tjetrin dhe pjesemarrja ne kete mbledhje do te perbeje prezencen personale te ketyre anetareve ne ate mbledhje. Kerkesat e njoftimit te Seksionit 3.4 ketu do te zbatohen per mbledhjet e mbajtura sipas Seksionit 3.13 nese te gjithe drejtoret jane pjesemarres, mund te degjojne njeri-tjetrin dhe mund te heqin dore gojarisht per kete njoftim, ne fillim te mbledhjes.

**NENI IV**

4.1 Nepunesit
Nepunesit e shoqates do te jene Presidenti dhe Drejtori ekzekutiv; Zevendepresidenti, Drejtori financiar dhe i Thesarit, Zevendespresidenti per Programin e Zhvillimit dhe Sekretari, Zevendespresidenti per Investimet, Drejtori per Veprimtarine ne Shqiperi, dhe nepunes te tjere qe Bordi i Drejtoreve mund te zgjedhe. Cdo dy ose me shume detyra mund te mbahen nga i njejti person.

4.2 Zgjedhja dhe Afati, Kualifikimet
Te gjithe nepunesit do te zgjidhen nga Bordi i Drejtoreve ne mbledhjen vjetore te pershkruar ne Seksionin 3.2 ketu dhe do te sherbejne deri ne mbledhjen tjeter vjetore te Bordit te Drejtoreve dhe pas kesaj deri ne ate kohe sa zevendesuesit perkates te tyre te jene zgjedhur dhe kualifikuar ose deri ne doreheqjen ose zevendesimin e tyre me te shpejte. Ne rast te nje vendi bosh, zgjedhja e ketij nepunesi mund te vendoset ne ate kohe dhe ne ato rrethana te percaktuara nga Bordi i Drejtoreve.

4.3 Presidenti dhe Drejtori Ekzekutiv
Presidenti dhe Drejtori Ekzekutiv do te jete Nepunesi kryesor ekzekutiv i shoqates. Subjekt i drejtimit dhe kontrollit te Bordit te Drejtoreve, Kryetari dhe Zevendeskryetari, do te kete te drejten te manaxhojne, mbikqyrin dhe kontrollojne aktivitetet dhe programet e shoqates dhe te permbushin aktet, kontratat, qirate dhe instrumenta te tjere ligjore dhe dokumenta ne emer te shoqates dhe do te kryejne detyra te tjera sic mund te jete percaktuar nga Bordi i Drejtoreve.

4.4 Drejtoret manaxhues te veprimtarive te Shqiperise
Drejtoret manaxhues te veprimtarive te Shqiperise do te jete Drejtori Operativ i shoqates ne Shqiperi dhe do te kryeje ato detyra qe mund t'i caktohen nga Bordi i Drejtoreve.

4.5 Nepunes te tjere
Nepunes te tjere mund te zgjidhen me vendim te Bordit te Drejtoreve dhe do te kene ato kompetenca dhe detyra sic mund te jene percaktuar nga Bordi i Drejtoreve ne ate vendim.

4.6 Shperblimi i nepunesve
Ne perputhje me Dokumentin SEED dhe objekt i Seksionit 501 (c ) (3) te Kodit, pagesa ose shperblimi i arsyeshem (perfshire pa kufizim, bonus ose shperblime stimuluese) per sherbime te te gjithe nepunesve te

shoqates do te vendoset nga vendimi i Bordit te Drejtoreve dhe asnje nepunes nuk do te ndalohet te marre kete shperblim per arsye se ky nepunes sherben gjithashtu si drejtor i shoqates.

4.7 Zevendesimi

Cdo nepunes i zgjedhur nga Bordi i Drejtoreve mund te zevendesohet ne cdo kohe, me ose pa shkak, me vendim te Bordit te Drejtoreve. Cdo vend bosh ne cdo zyre te shoqates mund te mbushet per nje periudhe te pacaktuar kohe me vendim te Bordit te Drejtoreve ne perputhje me Seksionin 4.3 ketu.

**NENI V**
**POLITIKAT E VEPRIMTARISE**

5.1 Politikat e pergjithshme te veprimtarise

Si ceshtje politike, shoqata do te marre, parashikoje ose leshoje, sipas rastit, hua, grante, investime equity, studime te pershtatshme, asistence teknike, trajnime, garanci dhe masa te tjera ("Asistence") deri ne masen qe keto veprime jane ne perputhje me Dokumentin SEED, Seksioni 501 (c) (3) te Kodit dhe objektin e shoqates sic eshte percaktuar ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut.

5.2 Politika te tjera te veprimtarise

Bordi i Drejtoreve, Kryetari, Zevendeskryetari dhe nepunesit e shoqates do te drejtohen nga politikat shtese te meposhtme:

A. Shoqata do te marre parasysh konsiderata te tilla si te drejtat nderkombetare te njohura punonjesve si dhe te drejtat nderkombetare te njeriut, faktoret e mjedisit, ekonomine e Shteteve te Bashkuara dhe efektet e punesimit dhe mundesine e vazhdueshmerise se aktivitetit qe perfiton asistence nga shoqata.

B. Shoqata mund te mbaje fonde me interes ________ para pageses se ketyre fondeve per cdo qellim te lejuar dhe mund te mbeten per keto qellime cdo interes i rrjedhur nga keto depozita pa i kthyer keto interesa ne Thesarin e Shteteve te Bashkuara dhe pa appropriation nga Kongresi i Shteteve te Bashkuara.

C. Ne perputhje me Seksionin 201(i) te Dokumentit SEED dhe objekt i Seksionit 501 (c ) (3) te Kodit, shoqata si ne menyre direkte ashtu edhe nepermjet shoqerive pjesemarrese (ashtu si ky term eshte percaktuar ketu) mund te solicit, marre dhe perdore kapiatl per cdo qellim investimi te ligjshem qe Bordi i Drejtoreve mund te percaktoje ne zhvillimin e politikave te tij.

D. Shoqata do te ndermarre te gjithe perpjekjet e mundshme per te themeluar instrumenta financiare qe do te bejne te mundur qe personat te investojne ne sektorin privat te Shqiperise dhe do te kete si efekt shumefishimin e subvencioneve te Shteteve te Bashkuara ndaj shoqates.

E. Asnje pjese e fondeve te shoqates nuk do te perdoret per perfitimin e asnje drejtori, nepunesi ose punonjesi te shoqates, pervec kur shoqata do te autorizohet per te paguar pagat ose shperblimet e arsyeshme (perfshire dhurata ose kompensime stimuluese) per sherbimet e kryera ose rimbursimet e shpenzimeve qe vijne ne lidhje me keto sherbime dhe te beje pagesat dhe shperndarjen ne avance per qellimet e percaktuara ne Seksionin 1.3 ketu.

F. Shoqata do te siguroje (i) qe cdo perfitues i asistences nga shoqata te mbaje (a) llogari te vecanta ne lidhje me asistencen, (b) regjistrime te tilla qe mund te behen te nevojshme ne menyre te arsyeshme

per te deklaruar plotesisht shumen dhe gadishmerine e ketyre perfituesve gjate dhenies se asistences, kostoja totale e projektit ose e marre persiper ne lidhje me ate te cilit asistenca eshte dhene ose perdorur dhe shuma dhe natyra e asaj pjese te kostos se projektit apo ndihmat e marra nga burime te tjera, dhe (c) regjistrime te tjera te cilat do te lehtesojne kryerjen e revizionimit, dhe (ii) qe Shoqata, apo ndonje nga perfaqesuesit e autorizuar, kane te drejta ne lidhje me propozimet per revizionimin dhe kontrollin e librave, dokumentave, letrave dhe faturave te marresve te cilat jane detyre e asistences.

**NENI VI.**
**ZHDEMTIMI**

6.1. Zhdemtimi ne lidhje me Ankimet e Paleve te Treta.

Shoqata, per aq sa eshte e lejueshme, dhe ne menyren e kerkuar nga ligjet e Shtetit te Delaware si dhe per efekt te adoptimit te ketij Neni apo te ndonje ligji i cili mund te ndryshoje here pas here, do te zhdemtoje çdo person i cili eshte apo ka qene drejtor apo nepunes i shoqates, dhe do te kete te drejten te zhdemtoje çdo person i cili eshte apo ka qene nje punonjes apo agjent i shoqates, ne rast se ky person eshte apo ka perbere pale apo eshte rrezikuar te jete pale e ndonje veprimi te lene pergjysem apo te plote, gjykimi (duke perfshire edhe apelin), civil, penal, administrative apo me natyre hetimore (ndryshe nga e (ndryshe nga nje veprim ne favor te Shoqates), ne baze te fakteve qe ky person eshte apo ka qene nje drejtor, nepunes, punonjes apo agjent i shoqates, apo, ne kohen kur ai eshte apo ka qene nje drejtor, nepunes, punonjes apo agjent i shoqates, sherben apo ka sherbyer me kerkese apo per te perfaqesuar intersat e Shoqates si drejtor, nepunes, partner, fiduciar, punonjes apo agjent (nje Nepunes Zevendesues) i ndonje Shoqerie tjeter, partnershipi, joint venture, trusti, apo nga ndermarrje (nje "Entiteti me filiale"), kundrejt shpenzimeve (duke perfshire pagesen e avokateve dhe rimbursimet), kostot, gjykimet, gjobat, dhe shumat e paguara aktualisht dhe te kryera efektivisht nga nje person ne lidhje me kete veprim, gjykime ne rast se ky person vepron ne mirebesim dhe ne nje menyre per te cilen keta persona besojne qe jane ne favor dhe jo ne kundershtim me interesat e Shoqates, dhe ne lidhje me veprimet kriminale apo gjykimet, nuk kane pasur arsyen per te besuar se kjo apo ai veprim i tyre ka qene i paligjshem; duke siguruar, gjithsesi, se Shoqata nuk do te jete e detyruar te zhdemtoje kundrejte ndonje shume te paguar vetem ne rast se Shoqata ka dhene aprovimin per kete pagese, aprovim i cili nuk mund tre refuzohet.

6.2. Zhdemtim ne lidhje me pasojat e ankimeve.

Shoqata, me kompetencat te cilat i lejohen dhe ne menyren e kerkuar nga ligjet e Shtetit Delaware ne fuqi, gjate kohes ne te cilen merret per baze ky Nen apo keto ligje mund te ndryshojne here pas here, do te zhdemtoje çdo person cile eshte apo ka qene drejtor apo nepunes i shoqates, dhe do te kete kompetencen te zhdemtoje çdo person i cili eshte apo ka qene drejtor apo nepunes i shoqates, ne rast se ky person ben apo ka bere pjese si pale apo eshte rrezikuar te jete pale e ndonje veprimi te lene pergjysem apo te plote, gjykimi (duke perfshire edhe apelin) te sjelle ne favor te Shoqates per te ndjekur nje gjykim ne favor te saj ne baze te fakteve se ky person eshte apo ka qene nje drejtor, nepunes, punonjes apo agjent i shoqates, apo, ne kohen kur ai eshte apo ka qene drejtor, nepunes, punonjes apo agjent i shoqates, i cili sherben apo ka sherbyer me kerkese te saj apo per te perfaqesuar interesin e Shoqates si nje Nepunes Zevendesues te

nje Entiteti te Degezuar kundrejt shpenzimeve (duke perfshire shpenzimet e avokateve dhe rimbursimet) dhe shpenzimet e kryera aktualisht nga keta persona ne lidhje me keto veprime ne rast se keta persona duke vepruar ne miremesim dhe ne nje menyre ne te cilen ata besojne se eshte apo nuk eshte ne kundershtim me interesat e shoqates, dhe me perjashtim qe asnje zhdemtitm do te kryhet ne lidhje me ndonje ankese, çeshtje per te cilen keta persona do te jene caktuar te jene pergjegjes ndaj Shoqates vetem nese, dhe me perjashtim qe Gjykata e Shansit e Shtetit te Delaware apo gjykata ne te cilen do te kryhet ky gjykim do te vendos ne baze te aplikimit qe edhe pse percaktimi i pergjegjesise por ne pikeveshtrimin e te gjitha rrethanave

6.3. Veprimet e nisura nga Pala e zhdemtuar.
Pavaresisht nga sa parashikohet ne Kapitullin 6.1 dhe Kapitullin 6.2, Shoqates i kerkohet te demshperbleje nje person ne lidhje me nje proces te filluar nga ky i fundit vetem kur ky proces te jete autorizuar nga Bordi i Drejtoreve.

6.4. Percaktimi i autorizimit te demshperblimit.
Demshperblimi sipas Kapitullit 6.1 apo 6.2 (perveç kur urdherohet nga gjykata) do te kryhet nga Shoqata siç lejohet per rastin konkret me percaktimin se demshperblimi behet sipas rrethanave sepse ky person permbush standartin e zbatueshem te sjelljes te parashikuar ne Kapitullin 6.1 ose 6.2. Ky percaktim do te behet (i) nga Bordi i Drejtoreve me shumice votash te kuorumit qe perbehet nga Drejtoret qe nuk ishin pjesemarres ne veprim, padi ose çeshtje ne lidhje me te cilat eshte kerkuar demshperblim ose me shumice votash te anetareve te nje komisioni te Bordit te Drejtoreve i perbere te pakten nga tre anetare, secili jo pjesemarres ne veprimin, padine ose çeshtjen ne fjale, ose (ii) neqoftese nuk plotesohet ky kuorum dhe/ose komisioni nuk eshte vendosur apo plotesuar, ose edhe ne rast se eshte plotesuar, kur kuorumi i perbere nga drejtore te painteresuar drejton ne kete menyre nga keshilltar ligjor i pavarur me opinion me shkrim, ose (iii) nga Anetaret. Kur nje person ne perputhje me Kapitullin 6.1 ose 6.2 ben kerkese per demshperblim, Shoqeria do te beje percaktimin jo me vone se gjashtedhjete (60) dite pas paraqitjes se kerkeses.

6.5 Zhdemtimi nepermjet gjyqeve
Ne kufijte qe nje drejtor, i punesuar ose agjent i shoqates ka qene i suksesshem me merite ose perndryshe ne mbrojtje te ndonje veprimi apo me shume, nje procedimi te referuar ne Seksionin 6.1 ose 6.2 ketu, ose ne mbrojtje te ndonje padie, ceshtjeje tjeter, ky person, ne rast se nje drejtor ose nepunes, do te zhdemtohet dhe ne rast se nje i punesuar ose agjent mund te zhdemtohet nepermjet shpenzimeve (perfshire shperblimet dhe shpenzimet e avokateve) dhe kostot qe ne fakt ose ne menyre te arsyeshme jane bere nga ky person ne lidhje me sa me siper.

6.6 Parapagimi i shpenzimeve
Shpenzimet dhe kostot e bera nga cdo person te referuar ne Seksionin 6.1 dhe 6.2 ne mbrojtje te nje veprimi civil, kriminal, administrative ose hetimi, ose procedim do te paguhet nga shoqata perpara perfundimit te ketij veprimi ose procedimi nepermjet fatures ose deklarates se ketij personi ne emer te tij per te paguar kete shume nese ajo do te rezultoje qe ai person nuk eshte i autorizuar te zhdemtohet nga shoqata sic autorizohet nga ky nen.

Zevendesuesit

E drejta e cdo personi qe eshte ose ishte drejtor, nepunes, i punesuar ose agjent i shoqates per t' demshperblyer sipas ketij neni do te vazhdoje pasi ai nuk eshte me drejtor, nepunes, i punesuar ose agjent dhe do te pershtatet me perfitimin e pasuesve, shperndaresve, administratoreve dhe perfaqesuesve te tjere ligjore te ketij personi.

6.8. Sigurimi. Shoqata ka kompetence per te marre dhe siguruar ne emer te çdo personi i cili ishte ose eshte ne cilesine e drejtorit, nepunesit, te punesuarit ose agjentit te shoqates, eshte duke punuar ose ka punuar me kerkesen e, ose perfaqeson interesat e shoqates si nje nepunes zevendesues i cdo shoqerie filiale, kunder cdo pergjegjesie te konfirmuar kunder cdo personi dhe qe rrjedh nga ky person ose ngrihet nga statusi i ketij personi duke e patur shoqata ose jo te drejten per te demshperblyer ate person kundrejt kesaj pergjegjesie sipas parashikimeve te ketij neni ose ligjit te aplikueshem.

6.9. Demshperblimi jo ekskluziv. Parashikimet e ketij neni, objekt i klauzolave te Dokumentit SEED, nuk do te kufizojne ne asnje menyre te drejten e shoqates per te demshperblyer apo paguar paraprakisht shpenzimet dhe kostot ne favor te nje personi ne çdo menyre te lejuar nga ligji ose qe konsiderohet e drejte ekskluzive e saj dhe nuk do te shfuqizojne asnje te drejte sipas se ciles nje person qe kerkon demshperblim ose pagesen e shpenzimeve paraprakisht mund te kete te drejte ne baze te nje ligji, marreveshje, votes se Anetareve ose ndryshe si duke vepruar ne cilesine e tij si nepunes, drejtor, i punesuar ose agjent i shoqates ashtu dhe duke vepruar ne cdo cilesi tjeter nderkohe qe mban nje pozicion te tille.

6.10. Perkufizimi i disa termave. (a) Per qellimet e ketij neni, "shoqeri" perveç shoqates ne fjale nenkupton pervec shoqates se krijuar (perfshire çdo perberes te nje perberesi) te perfshire ne nje bashkim i cili nese ekzistenca e shoqates se tij do te kishte vazhduar, sipas bazes ligjore do te lejohej te demshperblente drejtoret, nepunesit, te punesuarit ose agjentet e kesaj shoqate ekzistuese ose qe eshte ose ka sherbyer me kerkesen e saj ose ka perfaqesuar interesat e, kesaj shoqate ekzistuese si nje drejtor, nepunes, i punesuar ose agjent i cdo shoqerie filiale do te mbaje te njejtin pozicion sipas parashikimeve te ketij neni ne lidhje me shoqaten ekzistuese ashtu si ky person do t'i kishte ne lidhje me shoqaten ekzistuese nese ekzistenca e vecante do te vazhdonte.

(b) Per qellimet e ktij neni, referenca tek "Gjobat" do te nenkuptoje cdo takse te vendosur mbi personat ne lidhje me nje plan punesimi perfitues; refernca tek "Sherbim me kerkese te shoqates" do te nenkuptoje cdo sherbim si drejtor, nepunes, person i besuar, i punesuar ose agjent ne lidhje me nje plan punesimi perfitues; dhe nje person qe vepron ne mirebesim dhe ne menyre te arsyeshme besohet te jete ne interesin e pjesemarresve dhe perfituesve te nje plani punesimi perfitues do te konsiderohet te kete vepruar ne menyre "jo ne kundershtim me te miren e shoqates" sipas referimit ne kete nen.

**NENI VII**
**RAPORTET FINANCIARE DHE REVIZIONIMET**

7.1. Raporte. Ne baze te Dokumentit SEED, duke filluar qe nega viti 1996, shoqata do te botoje nje raport vjetor per vitin financiar paraardhes jo me vone se 31 Janari i çdo viti. Ky raport do te permbaje nje deklarim te plote dhe te detajuar te veprimtarise, aktivitetit, gjendjes financiare dhe arritjeve te shoqates per vitin financiar paraardhes.

7.2. Revizionimet. Llogarite e shoqates do te revizionohen çdo vit ne perputhje me standartet per revizionimet te miratuara ne pergjithesi, nga eksperte kontabel te pavarur te autorizuar ose te miratuar nga nje institucion shteteror apo politik i Shteteve te Bashkuara. Raporti i çdo eksperti te pavarur do te perfshihet ne raportin e kerkuar nga Kapitulli 7.1.

**NENI VIII**
**DISPOZITA TE FUNDIT**

8.1. Standartizimi i kohezgjatjes se detyres: Pasojat e zgjedhjes.
Kohezgjatja e detyres se drejtorit dhe nepunesve do te filloje ose mbaroje gjate mbledhjes vjetore te Anetareve te Bordit te Drejtoreve, sipas rastit, qe zhvillohet ne vitin financiar ne te cilin keto afate fillojne ose mbarojne, perveç afatit te rezervuar per çdo drejtor apo nepunes pas mbledhjes vjetore, derisa te emrohen dhe te marrin detyren. Kohezgjatja e detyres se drejtorit apo nepunesit te zgjedhur ne vazhdim te afatit te rregullt per keto detyra do te llogaritet sikur ky drejtor ose nepunes eshte zgjedhur diten kur ka filluar ky afat. Zgjedhja e drejtorit apo nepunesit eshte e mjaftueshme per t'i caktuar ne kete detyre dhe nuk kerkohet aprovim.

8.2. Konflikt interesash.
(a) Subjekt i kerkesave te Dokumentit SEED dhe Kapitullit 501(c)(3) te Kodit, kur nje drejtor apo nepunes i shoqates, bashkeshort apo femije i tyre, eshte drejtor apo nepunes i shoqates apo ka interes financiar ndaj shoqates, ndaj nje shoqerie tjeter, partneritet apo organizim tjeter me te cilen shoqata ka lidhur ose synon te lidhe kontrate, te dhuroje apo te hyje ne biznes, atehere drejtori ose nepunesi do te reklamoje me shkrim çdo fakt material per marredheniet ose interesat e tij/saj ose te bashkeshortit/es apo femijeve te tij/saj, sipas rastit. Ai drejtor ose nepunes do te perjashtohet nga pjesemarrja e shoqates ne keto kontrata, dhurime apo marredhenie biznesi; sidoqofte duhet pasur parasysh qe ky drejtor do te logaritet ne kuorumin e mbledhjeve te Bordit te Drejtoreve ku kjo kontrate, dhurim, biznes lejohet, miratohet ose ratifikohet ose eshte objekt diskutimi.
(b) Asnje drejtor apo nepunes nuk do te perdore per perfitim financiar ose perfitim te tjera informacionin sekret qe i behet i njohur si pasoje e pozites se tij ne shoqeri. Perveç kesaj, asnje nepunes apo person tjeter i punesuar nga shoqata nuk do te perdore per perfitim financiar apo perfitim tjeter çdo informacion qe i perket shoqates (sekret apo jo).

8.3. Vula e shoqates. Vula e shoqates do te kete formen e pershkruar nga Bordi i Drejtoreve.

8.4. Selia dhe zyra kryesore e shoqates. Ne perputhje me GCL, shoqata do ta kete seline ne Shtetin e Delaware. Zyra kryesore e shoqates do te jete ne New York, New York.

8.5. Viti Financiar. Viti financiar i shoqates fillon me 1 Tetor dhe mbaron me 30 Shtator.

8.6. Urdherat. Urdherat e Robert do te udheheqin te gjitha çeshtjet qe nuk parashikohen nga ky statut.

8.7. Kontrolli ndaj statutit. Kompetenca per te ndryshuar ose anuluar statutin dhe per te bere nje statut te ri do te ushtrohet nga vota e shumices te te gjithe Drejtoreve amerikane te shoqates neqoftese nuk ka vende bosh.

Perktheu nga anglishtja

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE

# RAPORT VLERESIMI

# PASURI E PALUAJTESHME

GJIN PERGEGAJ
VLERESUES SHK.I
NR. LIC. 0005

# RAPORT VLERESIMI

**PER PRONEN :**

TRUALL DHE NDERTESE

PORTEZ

FIER

**Pergatitur per llogari te "GLOBAL" sha.**

**T I R A N E, DHJETOR 2004**

# PERMBAJTJA

Adresa

Instruksioni

Vendndodhja

Pershkrimi

Siperfaqet

Sherbimet

Urbanistika

Pronesia

Kushtet

Vleresimi

Konkluzione

## ADRESA E SUBJEKTIT

Truall dhe ndertese ,

Fshati Portez,

Rrethi Fier.

## INSTRUKSIONI

Ne perputhje me kerkesen tuaj date 06.12.2004. po ju paraqesim kete raport vleresimi.

Raporti eshte konfidencial dhe perdoret per te ditur vleren e kapitalit si truall dhe ndertese dhe per ta rregjistruar ate ne Gjykate.

As i tere dhe as nje pjese e ketij raporti nuk mund te perfshihet ne ndonje dokument te botuar dhe as nuk mund te botohet pa miratimin tim.

Per probleme te prones ju mund te lidheni edhe me profesioniste te tjere por, pa e perdorur kete raport vleresimi

## VENDNDODHJA

Subjekti lokalizohet ne fshatin Portez Fier.
Ai percaktohet :
ne distance rreth 250m nga rruga Nacionale Fier Berat,
300 m nga kryqezimi i kesaj rruge me rrugen Fier Patos.

Zona perreth eshte zone banimi dhe industriale.
Me topografi te terrenit te rrafshte ,
Me zhvillim te shpejte ne keto vitet e fundit,

Hyrja per ne prone eshte e lokalizuar drejtperdrejt me rrugen qe lidh subjektin me rrugen Nacionale.

## PERSHKRIMI

Subjekti eshte ndertuar per te funksionuar si pike per tregetim gazi.
Ne te jane kryer investime per rrethimin , shtrimin e sheshit, ndertimin e zyrave, dhe te pikes se tregetimit te gazit.

## SIPERFAQET

| | | |
|---|---|---|
| Toka(truall) | rreth | 4 950 m² |
| Pika e tregtimit (reparti bombulave) | rreth | 430 m² |
| Anekse | rreth | 20 m² |

POZICIONI I PRONES NE LIDHJE ME RRUGEN NACIONALE FIER-BERAT



PIKE SHITJE GAZI
PLANVENDOSJA E TRUALLIT DHE DEPOZITAVE
FSHATI PORTEZ FIER
SHK. 1:1000




1. Muri Rethues
2. Porta
3. Peshore Elektronike
4. Depozitat

## SHERBIMET

Ne subjekt funksionojne :

Furnizimi me energji elektrike dhe furnizimi me uje.

## URBANISTIKA

Ne planet urbanistike zona eshte zone banimi dhe zone industriale.

Rruga qe lidh subjetin me rrugen Nacionale eshte e shtruar me stabilizante.

Eshte supozuar se nuk ka kufizime qe mund te ndikojne ne shitjen dhe Perdorimin e Pasurise.

## PRONESIA

Eshte supozuar qe pasuria me nr: 29/3 eshte ne pronesi te z. Ilir Karcini Dhe z. Skender Hamonikaj sipas plan vendosjes te vene ne dispozicion nga Klienti, **si truall dhe ndertese.**

...UESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

**ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME**

FIER

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2890 NR. I PASURISE 29/4 VOL. 1 FQ 47

INDEKSI I HARTES K-34-112(228-C) SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER Q/F PATOS

B. KUFIZIMET

V. PASURIA 29/5

L. PASURIA 111

J. PASURIA 29/6

P. PASURIA 29/3; 110.

C. PRONARI

FIRMA PRIVATE "GLOBAL-GAS" SHA.

D. Data: 18/12/2002. Ora: 12



## LIMITET E KUSHTEVE

Nuk eshte kryer nje mbikqyrje strukturale e prones.

Komentet kufizohen vetem me inspektimin siperfaqesor, duke u nisur

nga gjendja ekzistuese e saj.

Subjketi eshte inspektuar ne nivelin e katit perdhe.

## VLERESIMI

Ka per qellim te vleresoje pronen me metodat e tregut qe perdoren aktualisht ne daten e vleresimit 13.12.2004. ne nje treg te lire dhe te hapur.
Vlera e tregut te lire ( perkufizohet sipas Komitetit Nderkombetar te Standarteve te Vleresimit ) :

**„ Shuma e vleresuar per te cilen nje prone shkembehet me daten e vleresimit midis nje shitesi te vullnetshem dhe nje bleresi te vullnetshem ne nje transaksion normal pas nje marketingu te pershtatshem, ku palet veprojne ne nje menyre te vetedijshme dhe pa detyrim qe kerkohet nje kohe per negocim.“**

Ne kete raport vleresimi jane perdorur **Metodat e Kostos se Vleresuar e cila** merr parasysh koston e vleresuar te ndertimit te subjektit si truall , ndertse dhe si repart bombulash per tregetimin e gazit.
Sipas kuptimit te tyre vlera e subjektit eshte:

**Toka (trualli)** **rreth 9 000.000 leke.**

**Zyra dhe reparti I bombualve e anekse rreth 37.000.000 leke,**

# *KONKLUZION*

1. Subjekti, Truall , ndertese dhe reparti i bombulave,

Me vendodhje ne fshatin Portez, rrethi Fier,

Me pronare z. KARCINI dhe z. HAMONIKAJ,

Eshte vleresuar me metoden e kostos se vleresuar qe

perdoret aktualisht per perdorimin egzistues,

si subjekt per tregetimin e gazit.

Me vleren :

TRUALLI rreth 9 000 000 leke (nente milion leke).

NDERTESA rreth 37 000 000leke (tri dhjete e shtate milion leke).

TOTAL KAPITAL I INVESTUAR rreth 46 000 000leke (dyzete e gjashte milion leke) .

Gjin Pergegaj

VLERESUES I SHKALLES PARE

R"M.Grameno",P.5,Shk.1,Ap.2,Tirane

Tel : 373 605

Mobil : 0682129534

Nr. Licences 005

Nipt K 3907278 J

Firma

Tirane, me 13.12.2004.



GJIN PERGEGAJ
VLERESUES SHK. I
NR. LIC. 0005

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Dega Tatime e Taksa e Rrethit

K. 31528048 J

Kodi fiskal

BIZNES I VOGEL

**ÇERTIFIKATË**
**REGJISTRIMI**
**NË ORGANIN TATIMOR**

Nr. serial **8028055**

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE
DEGA TATIME E TAKSA E RRETHIT

KODI FISKAL



K. 31528048 J

Lëshuar Z.

Llojet e Biznesit që ushtron
a)

REGJISTRUAR NE GJYKATE ME VENDIM
Nr. Datë 22.02.2000

Data e Regjistrimit në Organin Tatimor

Kthime të përkohshme të çertifikatës

Adresa e banimit

Periudha e veprimtarisë
Nga 04 Deri me 31.12.2004

Vërtetohet marrja e çertifikatës dhe njohja me ligjet e sistemit fiskal.

Vendi i ushtrimit të Biznesit
1.
2.
3.

( )

Kryetari i Degës Tatime e Taksa të Rrethit

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT

DHE

SHOQERIA E VLERESUESVE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

SVP

# LIÇENSE

Nr. 0005 Datë 6/03/2001

PER
USHTRIM PROFESIONI NE
VLERESIMIN E PASURIVE TE PALUAJTSHME

**Z. Gjin Pjetri (Përgegaj)**

LEJOHET TE USHTROJE PROFESIONIN E

## VLERESUESIT (Shkalla e I-rë)

KRYETARI I KOMISIONIT
Ministri
SPARTAK POÇI

PRESIDENTI I SVP-së
EDVIN HOXHAJ

TIRANE, ME 20/03/2001

**SHOQERIA " GLOBAL GAZ " SH.A**

---

# VENDIM

Ne Fier sot ne daten 24.12.2003, ne seline e shoqerise u mblodh Keshilli i Ri Mbikqyres se shoqerise "Global Gaz"sh.a, person juridik shqiptar, i rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane nr 24922 date 11.01.2001, i zgjedhur ne Mledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise dates 24.12.2003, dhe me unanimitet

# VENDOSI

1. Emerimin ne detyren e kryetarit te Keshillit Mbikqyres se shoqerise te z. Skender Amoniku,e anetare ZZ Jeffery T. Griffin Rovena Karcini,
2. Pranimin e kerkeses se z. Skender Amoniku, per doreheqje nga detyra e Drejtorit te shoqerise .
3. Emerimin ne vend te ten ne detyren e Drejtorit te shoqerise te z. Ilir Karcini
4. Te pasqyrohet ky ndryshim ne aktet e shoqerise .
5. Ngarkohet Drejtori i ri shoqerise z. Ilir Karcini te beje depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

KESHILLI MBIKQYRES I SHOQERISE

Skender Amoniku,

Jeffery T. Griffin

Rovena Karcini

**REPUBLIKA SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR 766/REP NR KOL 66**

---

# V E R T E T I M

Ne Tirane sot ne daten 24.12.2003, para meje noteres Dhimitra Qarri, e rregjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane, me zyre Noteriale Blv "Gjergj Fishta " prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, u paraqiten personalisht :
**Skender Amoniku**, i biri i Hysenit, datlindja 1964, banues ne Fier ,i njohur personalisht prej meje noteres ,
**Rovena Karcini**, e bija e Serjan, datlindja 1973, e njohur personalisht prej meje noteres,
**Aleksander Sarapuli**,i biri i Ilia , datlindja 1963, banues ne Tirane, i njohur perosnalisht prej meje noteres, me cilesine e perfaqesuesit me prokuren nr 805 Rep e 79 kol date 11.09.2003,Notere Dylbere Elmazaj, e **Jeffery T. Griffin** ,shtetas amerikan, perfaqesues ligjor i Fondit Shqiptaro Amerikan te ndermarjeve ,organizate jofitimprurese e rregjistruar ne shtetin Delaware ,Sh.B A , me perfaqesine e saj ne Shqiperi, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e anetareve te Keshillit Mbikqyres se shoqerise "Global Gaz"sh.a, person juridik shqiptar, i rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane nr 24922 date 11.01.2001, te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte vendimi nr 1 date 24.12.2003, i Keshillit Mbikqyres se shoqerise se mesiperme, i mare jashte kesaj zyre noteriale, e nenshkruajne ne pranine time dhe une noterja pasi e gjeta ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " e vertetoj ate .

N O T E R E

DHIMITRA QARRI

**REPUBLIKA E SHQIUPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr.** 805 **Rep.**
**Nr.** 79 **Kol.**

PULLE TAKSE

## PROKURE E POSAÇME

Ne Tirane, sot me date 11 Shtator 2002 (dymije e dy), perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqeit pesonalisht Z. Jeffrey T. Griffin, shtetas amerikan, lindur ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes me 14 Qershor 1944, mbajtes i pasaportes nr. Z8236285, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai, me vullnetin e tij te plote e te lire, me deklaroi sa me poshte vijon:

"Une i nenshkruari, Jeffrey T. Griffin, ne cilesine e perfaqesuesit ligjor te Fondit Shqiptaro Amerikan te Ndermarrjeve (Fondi), emeroj nepermjet kesaj prokure si perfaqesues te posaçem te Fondit, Z. **Aleksander Sarapuli** dhe **Z. Martin Mata**, dhe i autorizoj ata qe, sebashku oase veç e veç, te perfaqesojne Fondin gjate mungese time, duke nenshkruar çdo dokument qe lind nevoja te nenshkruhet gjate zhvillimit te aktivitetit te Fondit ne Shqiperi, si dhe te veprojne si perfaqesues te Fondit ne çdo shoqeri ne te cilen Fondi eshte ortak apo aksionar.
Perfaqesuesit nuk mund t'i delegojne personave te tjere asnje nga te drejtat qe u jane njohur nepermjet kesaj prokure."

Une Noteri, i lexoj me ze te larte Z. Jeffrey T. Griffin, sa me siper. Pasi Znj. Adriana Jorgji i perkthen tekstin e kesaj prokure nga gjuha shqipe ne anglisht, Z. Griffin me deklaron se permbajtja e saj perputhet plotesisht me theniet e tij dhe nenshkruan rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj kete prokure te posaçme sipas ligjt ne fuqi.

**I Perfaqesuar**
**Albanian American Enterprise Fund**
Perfaqesuar nga:

Z. Jeffrey Griffin
President & CEO

**Perktheu**

Znj. Adriana Jorgji

**Noter**

DHOMA E NOTEREVE
NR 372 REP
VERTETIM
ESHTE NJI ME ORIGJINALIN
NOTERI

**ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND**
**Tirana Office**
Tel/Fax: (+355) 4 222408; 223381; E-mail: *info@aaef.com*
Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit, "Green Park" Complex, Tower 2, 12th Floor
Tirana, ALBANIA

Nr. Prot. 4004

# V E N D I M

## I BORDIT TE DREJTOREVE TE
## ALBANIAN AMERICAN ENTERPRISE FUND

Bordi i Drejtoreve te Albanian American Enterprise Fund, i perfaqesuar nga Z.Jeffrey T. Griffin, sot ne daten 20.12 2003.

## V E N D O S I

1. Te bleje 12 aksione, te emetuara nga shoqeria "GLOBAL GAZ" sh.a, aksione te cilat kjo shoqeri i emeton per efekt te zmadhimit te kapitalit themeltar te saj, me vlere nominale sejcili 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije), kundrejt shumes se pergjithshme US$ 292.208 (dyqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US) ekuivalente 18 600 000 (tetembedhjetemilion e gjashteqindmije) leke.
2. Eshte dakort qe ne perberje te anetareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise "GLOBAL GAZ" Sh.a te jete te jete z. Jeffery T. Griffin.

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE TIRANE ALBANIA

**Jeffrey T. Griffin**
**President& CEO**

# ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND
**Tirana Office**
Tel/Fax: (+355) 4 222408; 223381; E-mail: *info@aaef.com*
Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit, "Green Park" Complex, Tower 2, 12th Floor
Tirana, ALBANIA


Nr. Prot. 4004.

## DECISION

## OF THE BOARD OF DIRECTORS OF THE ALBANIAN AMERICAN ENTERPRISE FUND

The Board of Directors of the Albanian American Enterprise Fund, represented by Mr. Jeffrey T. Griffin, President and CEO of AAEF, on 12.20.2003,

## DECIDED:

1. To purchase the 12 new shares issued by the Company "GLOBAL GAZ" Sh.a., such shares are issued as a consequence of the increase of the Company share capital and each share has a value of 1,550,000 Leke (one million and five hundred and fifty thousand Albanian Leke) per all, for the price of US$ 292,208 (two hundred and ninety two thousand and two hundred and eight dollars), equivalent to 18,600,000 (eighteen million and six hundred thousand Albanian leke).
2. Appoint Mr. Jeffrey T. Griffin as a member of the Supervisory Board of the Company "GLOBAL GAZ" Sh.a.

**Jeffrey T. Griffin**
**President& CEO**

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE TIRANE ALBANIA


**New York Office/ Zyra ne New York:**
**14 East 60th Street, Suite 407, New York, NY 10022**
**Tel: (+1 212) 702 9102; Fax: (+1 212) 702 0854**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 37 REP NR ___/KOL
Notere Dhimitra Qarri
Adresa : Blv Gjergj Fishta prane Gjykates se
Shkalles se Pare Tirane tel 251 200 / 0692095571

---

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane sot me daten 06 01 2001 para meje noteres publike Dhimitra Qarri u paraqit personalisht **Jeffery T.Griftin,** shtetas amerikan, datlindja 14.06.1944, banues aktualisht ne Tirane, me cilesine e perfaqesuesit ligjor te Fondit Shqiptaro Amerikan te Ndermarrjeve (FONDI), mbajtes i pasaportes nr Z 8223625, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me vullnetin e tij te lire e te plote, deklaroi se sa me siper eshte kerkese e redaktuar prej tij jashte kesaj Zyre noteriale, e nenshkruan ne pranine time dhe une Noterja e vertetoj ate konform ligjit......
Komunikimi me z. **Jeffery T.Griftin** u be ne gjuhen angleze nepermjet perkthyesit Eniel Koloneci, i njohur personalisht prej meje noteres,

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE
DHIMITRA QARRI

SHOQERIA "GLOBAL GAZ " SH.A

VENDIM

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQEEISE
"GLOBAL GAZ " SH.A
DATE 24,12.2003.

Sot me date 24.12.2003 (dymije e tre), ne seline e shoqerise "Global Gaz" SHA u mblodh Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te shoqerise. Ne mbledhje ishin te pranishem te gjithe aksionaret e shoqerise si vijon:

- **Ilir Karcini** zoterues i 49 aksioneve te kapitalit te shoqerise me vlere nominale Leke 1.550.000 sejcili (nje milion e peseqind e pesedhjete mije)

- **Skender Amoniku** zoterues i 51 aksioneve te kapitalit te shoqerise me vlere nominale Leke 1.550.000 sejcili (nje milion e peseqind e pesedhjete mije).

Asambleja eshte thirrur regullisht per te mare ne shqyrtim rendin e dites si me poshte:

1. Zmadhimi i kapitalit te shoqerise nepermjet emetimit te 12 aksioneve te reja

2. Marja e nje huaje nga ana e shoqerise prej Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve

3. Ndryshime ne statutin e Shoqerise

4. Pranimi i doreheqjes se anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe emerimi i anetareve te rinj

5. Te ndryshme.

Ne mbledhje eshte i pranishem quorumi i kerkuar nga ligji per te diskutuar dhe vendosur mbi pikat e mesiperme te rendit te dites.

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te shoqerise, pasi shqyrtoi çeshtjet e rendit te dites dhe degjoi raportin e paraqitur nga Drejtori dhe eksperti kontable i autorizuar i shoqerise, vendosi me unanimitet per çdo pike sa me poshte vijon:

*<u>Ne lidhje me piken e pare te rendit te dites</u>*

Te zmadhoje kapitalin e shoqerise nga Leke 155.000.000 (njeqind e pesedhjete e pese milion) ne Leke 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milion e gjashteqind mije), duke emetuar 12 (dymbedhjete) aksioneve te reja me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) secili.

Secili nga Aksionaret e Shoqerise heq dore nga e drejta e perparesise ne nenshkrimin e ketyre aksioneve te reja.
Asambleja i njeh Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarjeve ("Fondi") organizate jofitimprurese e krijuar sipas ligjeve te shtetit Delaware, USA, me seli ne USA dhe zyre perfaqesie ne Tirane, Shqiperi, te drejten qe te nenshkruaje dhe shlyeje 12 (dymbedhjete) aksionet e reja kundrejt shumes US$ 292.208 (dyqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US).

Si pasoje e ketij emetimi aksionesh kapitali i shoqerise do te perbehet nga 112 (njeqind e dymbedhjete) aksione me vlere nominale Leke 1.550.000 (njemilion e peseqind e pesedhjete mije) sejcili, e do te zoterohet nga aksionaret si vijon:

- **Skender Amoniku**, 51 aksione, qe perbejne 45,5 % te kapitalit te shoqerise pas zmadhimit

- **Ilir Karçini**, 49 aksione, qe perbejne 43,8 % te kapitalit te shoqerise pas zmadhimit

- **Fondi,** 12 aksione, qe perbejne 10,7 % te kapitalit te shoqerise pas zmadhimit.

*Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites:*

Fondi ka levruar ne favor te shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) sipas Marreveshjes se Huase nr. 477 rep., nr.1062 kol., 26 Gusht 2003 ("Marreveshja e Huase (A)").
Asambleja e Aksionareve autorizon shoqerine qe te marre nga Fondi hua ("Huaja") ne shumen US$ 676.328 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US) ("Principali"), ku perfshihet edhe shuma US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) e siperpermendur. Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane (qe perfshin edhe shumen US$ 450.000), dhe Marreveshja e Huase (A) do te modifikohet, sipas kushteve dhe afateve te meposhtme:

(i) Principal i Huase do te jete US$ 676.328.00 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US), prej te cilave Fondi ka levruar ne favor te Shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) sipas Marreveshjes se Huase (A);

(ii) Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane brenda 5 vjeteve; Principali do te filloje te paguhet pas dates 31 Janar 2005 dhe pagesat e Principalit do te jene ne keste tre mujore duke filluar nga 18 Marsi, 2005;

(iii) Interesi qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit eshte 12% ne vit; interesi do te paguahet çdo tre muaj dhe do te llogaritet duke filluar nga data 18 Shtator, 2003 per nje periudhe 5 vjeçare;

(iv) Huaja do te konsiderohet si nje Hua e shkalles se dyte, ne rast se Shoqerise do t'i jepet hua nga nje banke tjeter deri ne vleren e principalit prej 1,000,000.00 US$ (nje million dollare), pasi Fondi te jete siguruar qe asnje hua tjeter nuk eshte rregjistruar pas asaj te dhene nga Fondi;

(v) Nese Fondi eshte dakord, Huaja mund te konvertohet ne 33 aksione te reja te kapitalit te Shoqerise sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne

Ndryshimin e Marreveshjes se Investimit, te dates 24 Dhjetor 2003, nr. 7512 rep., nr. 1937 kol.. Huaja mund te konvertohet ne aksione te reja vetem brenda nje afati prej nje viti qe fillon ne date 18 Shtator, 2003 (Data e Levrimit) dhe perfundon ne date 18 Shtator 2004. Megjithate, Fondi ka te drejte te marre vendim nese do te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te shoqerise brenda dates 31 Janar 2005, pasi Shoqeria dhe aksionaret e saj t'i kene vene ne dispozicion te gjithe informacionin financiar e kerkuar nga Fondi per vitin financiar 2004 ne lidhje me aktivitetin e LPG-se (ku LPG do te kuptohet gazi i lengshem) te vete Shoqerise, si dhe te subjekteve te tjera ne te cilat Shoqeria ose aksionaret e saj kane pjesemarrje direkte ose indirekte (me poshte "Aktiviteti i Pergjitshem i LPG-se"). Nese deri ne date 31 Janar 2005, Fondi nuk ka vendosur te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, interesi i Huase qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit do te ne 9% ne vit. Ky efekt i zvogelimit te interesit te huase do te filloje nga data 18 Shtator 2004 dhe pagesa e interesit qo duhet te behej sipas rradhes ne muajin Dhjetor 2004 do te kryhet se bashku me kestin pasardhes te interesit ne diten perkates te muajit Mars 2005.
Nese Fondi vendos te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise duhet te vendose zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise 1, nepermjet emetimit te 33 aksioneve te reja dhe vlera e ketij konvertimi do te jete 6 here mesatarja e 2001/2002 EBITDA (ku EBITDA do te thote e ardhur perpara interesit, tatim fitimit e amortizimit per Aktivitetin e Pergjitshem te LPG-se.

Gjithashtu, Asambleja e Aksionareve te Shoqerise vendosi qe te mos zvogeloje Kapitalin e saj dhe mos kryeje ndonje operacion tjeter qe mund te ndikoje ne vleren dhe te drejtat qe do te gezoje Fondi me nenshkrimin dhe shlyerjen e 12 aksioneve te reja te emetuara sipas pikes (1) te rendit te dites dhe aksioneve te reja qe mund te nenshkruhen nga Fondi per konvertimin e Huase ne aksione te reja te kapitalit te shoqerise sipas pikes (v) me siper.

Aksionaret marrin persiper ne menyre te parevokueshme, qe ne proporcion me numrin e aksioneve qe zoterojne ne kapitalin e Shoqerise, te blejne nga Fondi nje pjese apo te gjithe aksionet qe zoterohen nga Fondi, sipas kerkeses se tij dhe sipas kushteve e afateve te parashikuara ne Marreveshjen e Investimit, te dates 12 Qershor 2003, no.3481 rep., no.835 kol. dhe te garantojne Fondin per permbushjen e ketij detyrimi te marre persiper, duke ngarkuar me barre siguruese aksionet e tyre ne favor te Fondit.

*Ne lidhje me piken e trete te rendit te dites;*

Disa nene te Statutit te shoqerise ndryshohen dhe/ose shtohen si vijon:

Permbajtja e nenit 5 ndryshohet si me poshte:

"NENI 5
KONTRIBUTET NE KAPITAL

Kapitali i shoqerise eshte 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milion e gjashteqind mije leke) i perbere nga 112 (njeqind e dymbedhjete) aksione me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) sejcili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht me kontribut ne para nga aksionaret.

Kapitali i shoqerise zoterohet nga aksionaret si vijon:

- Skender Amoniku, 51 aksione, qe perbejne 45,5 % te kapitalit te shoqerise
- Ilir Karçini, 49 aksione, qe perbejne 43,8% te kapitalit te shoqerise
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, 12 aksione, qe perbejne 10,7 % te kapitalit te shoqerise."

Permbajtja e nenit 6 ndryshohet si me poshte:

"NENI 6
RAPORTI I NDARJES SE FITIMIT

Fitimet qe rezultojne nga aktiviteti i shoqerise, pasi te jene bere zbritjet e kerkura nga ligji, mund te ndahen midis aksionareve ne raport me aksionet qe zoteron secili me vendim te Asambleja e Aksionareve te shoqerise."

Ne fund te nenit 14 te Statutit shtohet nje paragraf me kete permbajtje:

"Keshilli Mbikqyres eshte organ kolegjial dhe i ushtron kompetencat e veta nepermjet vendimeve te marra rregullisht prej tij. Keshilli Mbikqyres i merr te gjitha vendimet me unanimitet te te gjithe anetareve te tij."

Pas paragrafit te pare te nenit 15 te statutit shtohet nje paragraf tjeter me permbajtjen e meposhtme:

"Te pakten njeri nga dy anetaret e emeruar nga Asambleja e Aksionareve duhet te jete i propozuar nga aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, ne te kundert emerimi eshte i pavlefshem."

Permbajtja e paragrafit te pare i nenit 16 te Statutit ndryshon si vijon:

"Dy te tretat e Anetareve te Keshillit Mbikqyres emerohen me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionareve te shoqerise me kusht qe aksionari Foni Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve te kete votuar pro."

Permbajtja e paragrafit te peste te nenit 16 te Statutit ndryshon si vijon:

"Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te riemerohen ose rizgjidhen pas perfundimit te afatit te mandatit te tyre. Anetaret e emeruar me vendim te Asamblese se Aksionareve mund te shkarkohen ne çdo memoment me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionareve me kusht qe aksionari Foni Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve te kete votuar pro."

Paragrafi i fundit i nenit 16 te Statutit shfuqizohet.

Paragrafi i fundit i nenit 18 te Statutit shfuqizohet.

Pas nenit 22 te Statutit shtohet nje neni 22/1 me titull dhe permbajtje si me poshte:

"NENI 22/1

Shefi i finances se Shoqerise duhet te marre nje vleresim te pranueshem per aftesite profesionale nga nje prej shoqerive te auditimit te njohura si "Big Five".

Çdo propozim per emerime apo ndryshime ne strukturen organizative te shoqerise duhet te diskutohet dhe konsultohet nga ana e Drejtorise se shoqerise me Fondin."

Permbajtja e paragrafit te fundit te nenit 24 te Statutit ndryshohet si vijon:

"Vendimet e Asamblese se Aksionareve merren me shumicen e ¾ te votave te aksionareve, perveç rasteve kur ne kete Statut parashikohet ndryshe."

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me kete permbajtje:

"NENI 25/1

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme, vendimet per shit-blerjen e aseteve te shoqerise me vlere me te madhe se US$ 5.000 (pese mije dollare US) e vendime te tjera strategjike, si dhe vendimet per emerimin dhe/ose shkarkimin e anetareve te emeruar te Keshillit Mbikqyres, jane te vlefshem vetem nese aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve ka votuar pro."

*Ne lidhje me piken e katert te rendit te dites;*

Asambleja mori ne konsiderate deklaratat e paraqitura nga Z. Ilir Karçini, Z. Gezim Amoniku dhe Znj. Greta Angjeli per dorehqejen e tyre nga detyra e anetareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise, si dhe deklraten e Z. Skender Amoniku per doreheqjen e tij nga detyra e Drejtorit te shoqerise, dhe i miratoi ato.

Asambleja emeroi Z. Skender Amoniku dhe Z. Jeffery T. Griffin si anetare te Keshillit Mbikqyres, si dhe mori dijeni per zgjedhjen e Znj. Rovena Karçini nga te punesuarit ne shoqeri, si anetare e Keshillit Mbikqyres.
Per rrjedhoje Keshilli Mbikqyres perbehet nga:

- Z. Skender Amoniku
- Z. Jeffery T. Griffin
- Znj. Rovena Karçini.

*Ne lidhje me piken e peste te rendit te dites:*

Asambleja e Aksionareve ngarkon Drejtorin e shoqerise, i cili do te emerohet nga Keshilli Mbikqyres, dhe i jep atij kompetenca te plota per te pergatitur, nenshkruar dhe ekzekutuar çdo dokument qe nevojitet per te rregjistruar e depozituar ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane kete vendim dhe çdo ndryshim sipas tij.

**Aksioneret:**

Ilir Karçini

ILIR KARÇINI

Skender Amoniku

Skender Amoniku

**REPUBLIKA SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR 2660 REP NR KOL 661**

# V E R T E T I M

Ne Tirane sot ne daten 24.12.2003, para meje noteres Dhimitra Qarri, e rregjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane, me zyre Noteriale Blv "Gjergj Fishta " prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, u paraqiten personalisht :
**Skender Amoniku**, i biri i Hysenit, datlindja 1964, banues ne Fier, i njohur personalisht prej meje noteres
**Ilir Karcini**, i biri i Nisit, datlindja 1969, banues ne Tirane, i njohur personalisht prej meje noteres, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar , me cilesine e aksionereve te shoqerise "GLOBAL GAZ"sh.a, person juridik shqiptar, i rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane nr 24922 date 11.01.2001, te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte vendimi nr 1 date 24.12.2003 i asamblese se jashtezakonshme te shoqerise se mesiperme, i mare jashte kesaj zyre noteriale, e nenshkruajne ne pranine time dhe une noterja pasi e gjeta ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " e vertetoj ate .

**NOTERE**
**DHIMITRA QARRI**

24822/3

G'Enkela Bajo
08.01.2004

**SHOQERIA „GLOBAL-GAZ " SH.A**

**K E R K E S E**

**KERKUES**: Ilir Karcini,i biri i Nisit, datlindja 1969, banues ne Tirane , drejtori i pergjithshem i shoqerise „GLOBAL GAZ" sh.a.

**OBJEKTI**: Depozitimi prane Zyres se Rregjistrit tregetar te vendimit date 24.12.2003 te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise „ GLOBAL-GAZ " SH.A dhe te vendimit te Keshillit Mbikqyres te shoqerise date 24.12.2003 si dhe vendimit date 20.12.2003 te Fondit.

BAZA LIGJORE : Ligji 7667 date 28.1.1993 „Per Regjistrin Tregetar" dhe ligjit 7638 date 19.11.1992"Per shoqerite Tregetare"

PER KOMPETENCE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Une kerkuesi me cilesine e drejtorit te pergjithshem te shoqerise anonime "GLOBAL-GAZ " SH.A ju paraqes kerkesen per depozitimin prane Zyres se Rregjstrit Tregetar te vendimit , date 24.12.2003 asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise „ GLOBAL-GAZ " SH.A, e themeluar si e tille me vendimin e Gjykates Se Rrethit Tirane NR 24922 date 11.01.2001.
Me vendimin e mesiperm asambleja e jashtezakonshme e aksionereve te shoqerise „ GLOBAL-GAZ " SH.A ka vendosur:
Te zmadhoje kapitalin e shoqerise nga Leke 155.000.000 (njeqind e pesedhjete e pese milion) ne Leke 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milion e gjashteqind mije).
Zmadhimi i kapitalit eshte realizuar nepermjet emetimit 12 (dymbedhjete) aksioneve te reja me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) secili, te cilat, me miratimin e secilit aksionar, u nenshkruan dhe shlyen nga Fondi Shqiptaro-Amerikan te Ndermarjeve ("Fondi") organizate jofitimprurese e krijuar sipas ligjeve te shtetit Delaware, USA, me seli ne USA dhe zyre perfaqesie ne Tirane, Shqiperi, kundrejt shumes US$ 292.208 (dyqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US).
Si rrjedhoje e emetimit te aksioneve te reja, kapitali i shoqerise behet Leke 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milion e gjashteqind mije) i ndare ne 112 (njeqind e dymbedhjete) aksione me vlere nominale Leke 1.550.000 (njemilion e peseqind e pesedhjete mije) secili dhe zoterohet nga aksionaret si vijon:

- Skender Amoniku, 51 aksione, qe perbejne 45,5% te kapitalit
- Ilir Karçini, 49 aksione, qe perbejne 43,8 % te kapitalit
- Fondi, 12 aksione, qe perbejne 10,7 % te kapitalit

2. Fondi ka levruar ne favor te shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) sipas Marreveshjes se Huase nr. 477 rep., nr.1062 kol., 26 Gusht 2003 ("Marreveshja e Huase (A)").
Asambleja e Aksionareve autorizon shoqerine qe te marre nga Fondi hua ("Huaja") ne shumen US$ 676.328 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US) ("Principali"),

ku perfshihet edhe shuma US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) e siperpermendur. Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane (qe perfshin edhe shumen US$ 450.000), dhe Marreveshja e Huase (A) do te modifikohet, sipas kushteve dhe afateve te meposhtme:

(vi) Principal i Huase do te jete US$ 676.328.00 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US), prej te cilave Fondi ka levruar ne favor te Shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) sipas Marreveshjes se Huase (A);

(vii) Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane brenda 5 vjeteve; Principali do te filloje te paguhet pas dates 31 janar 2005 dhe pagesat e Principalit do te jene ne keste tre mujore duke filluar nga data 18 mars 2005;

(viii) Interesi qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit eshte 12% ne vit; interesi do te paguahet çdo tre muaj dhe do te llogaritet duke filluar nga data 18 shtator 2003 per nje periudhe 5 vjeçare;

(ix) Huaja do te konsiderohet si nje Hua e shkalles se dyte, ne rast se Shoqerise do t'i jepet hua nga nje banke tjeter deri ne vleren e principalit prej 1.000.000 US$ (nje million dollare), pasi Fondi te jete siguruar qe asnje hua tjeter nuk eshte rregjistruar pas asaj te dhene nga Fondi;

(x) Nese Fondi eshte dakord, Huaja mund te konvertohet ne 33 aksione te reja te kapitalit te Shoqerise sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne Ndryshimin e Marreveshjes se Investimit, te dates 24 dhjetor 2003, nr. 7512 rep., nr. 1937 kol.. Huaja mund te konvertohet ne aksione te reja vetem brenda nje afati prej nje viti qe fillon ne date 18 shtator 2003 (Data e Levrimit) dhe perfundon ne date 18 shtator 2004. Megjithate, Fondi ka te drejte te marre vendim nese do te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te shoqerise brenda dates 31 janar 2005, pasi Shoqeria dhe aksionaret e saj t'i kene vene ne dispozicion te gjithe informacionin financiar e kerkuar nga Fondi per vitin financiar 2004 ne lidhje me aktivitetin e LPG-se (ku LPG do te kuptohet gazi i lengshem) te vete Shoqerise, si dhe te subjekteve te tjera ne te cilat Shoqeria ose aksionaret e saj kane pjesemarrje direkte ose indirekte (me poshte "Aktiviteti i Pergjitshem i LPG-se"). Nese deri ne date 31 janar 2005, Fondi nuk ka vendosur te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, interesi i Huase qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit do te ne 9% ne vit. Ky efekt i zvogelimit te interesit te huase do te filloje nga data 18 Shtator 2004 dhe pagesa e interesit qo duhet te behej sipas rradhes ne muajin dhjetor 2004 do te kryhet se bashku me kestin pasardhes te interesit ne diten perkates te muajit mars 2005.

Nese Fondi vendos te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise duhet te vendose zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise 1, nepermjet emetimit te 33 aksioneve te reja dhe vlera e ketij konvertimi do te jete 6 here mesatarja e 2001/2002 EBITDA (ku EBITDA do te thote e ardhur perpara interesit, tatim fitimit e amortizimit per Aktivitetin e Pergjitshem te LPG-se).

Gjithashtu, Asambleja e Aksionareve te Shoqerise vendosi qe te mos zvogeloje Kapitalin e saj dhe mos kryeje ndonje operacion tjeter qe mund te ndikoje ne vleren dhe te drejtat qe do te gezoje Fondi me nenshkrimin dhe shlyerjen e 12 aksioneve te reja te emetuara sipas pikes (1) te rendit te dites dhe aksioneve te reja qe mund te nenshkruhen nga Fondi per konvertimin e Huase ne aksione te reja te kapitalit te shoqerise sipas pikes (v) me siper.

Aksionaret marrin persiper ne menyre te parevokueshme, qe ne proporcion me numrin e aksioneve

qe zoterojne ne kapitalin e Shoqerise, te blejne nga Fondi nje pjese apo te gjithe aksionet qe zoterohen nga Fondi, sipas kerkeses se tij dhe sipas kushteve e afateve te parashikuara ne Marreveshjen e Investimit, te dates 12 Qershor 2003, no.3481 rep., no.835 kol. dhe te garantojne Fondin per permbushjen e ketij detyrimi te marre persiper, duke ngarkuar me barre siguruese aksionet e tyre ne favor te Fondit.

Disa nene te Statutit te shoqerise ndryshohen dhe/ose shtohen si vijon:

Permbajtja e nenit 5 ndryshohet si me poshte:

"NENI 5
KONTRIBUTET NE KAPITAL

Kapitali i shoqerise eshte 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milion e gjashteqind mije leke) i perbere nga 112 (njeqind e dymbedhjete) aksione me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) sejcili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht me kontribut ne para nga aksionaret.
Kapitali i shoqerise zoterohet nga aksionaret si vijon:

- Skender Amoniku, 51 aksione, qe perbejne 45,5 % te kapitalit te shoqerise
- Ilir Karçini, 49 aksione, qe perbejne 43,8% te kapitalit te shoqerise
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, 12 aksione, qe perbejne 10,7 % te kapitalit te shoqerise."

Permbajtja e nenit 6 ndryshohet si me poshte:

"NENI 6
RAPORTI I NDARJES SE FITIMIT

Fitimet qe rezultojne nga aktiviteti i shoqerise, pasi te jene bere zbritjet e kerkura nga ligji, mund te ndahen midis aksionareve ne raport me aksionet qe zoteron secili me vendim te Asambleja e Aksionareve te shoqerise."

Ne fund te nenit 14 te Statutit shtohet nje paragraf me kete permbajtje:

"Keshilli Mbikqyres eshte organ kolegjial dhe i ushtron kompetencat e veta nepermjet vendimeve te marra rregullisht prej tij. Keshilli Mbikqyres i merr te gjitha vendimet me unanimitet te te gjithe anetareve te tij."

Pas paragrafit te pare te nenit 15 te statutit shtohet nje paragraf tjeter me permbajtjen e meposhtme:

"Te pakten njeri nga dy anetaret e emeruar nga Asambleja e Aksionareve duhet te jete i propozuar nga aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, ne te kundert emerimi eshte i pavlefshem."

Permbajtja e paragrafit te pare i nenit 16 te Statutit ndryshon si vijon:

"Dy te tretat e Anetareve te Keshillit Mbikqyres emerohen me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionareve te shoqerise me kusht qe aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve te kete votuar pro."

Permbajtja e paragrafit te peste te <u>nenit 16</u> te Statutit ndryshon si vijon:

"Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te riemerohen ose rizgjidhen pas perfundimit te afatit te mandatit te tyre. Anetaret e emeruar me vendim te Asamblese se Aksionareve mund te shkarkohen ne çdo memoment me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionareve me kusht qe aksionari Foni Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve te kete votuar pro."

Paragrafi i fundit i <u>nenit 16</u> te Statutit shfuqizohet.

Paragrafi i fundit i <u>nenit 18</u> te Statutit shfuqizohet.

Pas nenit 22 te Statutit shtohet nje <u>neni 22/1</u> me titull dhe permbajtje si me poshte:

"NENI 22/1

Shefi i finances se Shoqerise duhet te marre nje vleresim te pranueshem per aftesite profesionale nga nje prej shoqerive te auditimit te njohura si "Big Five".

Çdo propozim per emerime apo ndryshime ne strukturen organizative te shoqerise duhet te diskutohet dhe konsultohet nga ana e Drejtorise se shoqerise me Fondin."

Permbajtja e paragrafit te fundit te <u>nenit 24</u> te Statutit ndryshohet si vijon:

"Vendimet e Asamblese se Aksionareve merren me shumicen e ¾ te votave te aksionareve, perveç rasteve kur ne kete Statut parashikohet ndryshe."

Pas nenit 25 shtohet <u>neni 25/1</u> me kete permbajtje:

"NENI 25/1

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme, vendimet per shit-blerjen e aseteve te shoqerise me vlere me te madhe se US$ 5.000 (pese mije dollare US) e vendime te tjera strategjike, si dhe vendimet per emerimin dhe/ose shkarkimin e anetareve te emeruar te Keshillit Mbikqyres, jane te vlefshem vetem nese aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve ka votuar pro."

4. Asambleja mori ne konsiderate deklaratat e paraqitura nga Z. Ilir Karçini, Z. Gezim Amoniku dhe Znj. Greta Angjeli per dorehqejen e tyre nga detyra e anetareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise, si dhe deklraten e Z. Skender Amoniku per doreheqjen e tij nga detyra e Drejtorit te shoqerise, dhe i miratoi ato.
Asambleja emeroi Z. Skender Amoniku dhe Z. Jeffery T. Griffin si anetare te Keshillit Mbikqyres, si dhe mori dijeni per zgjedhjen e Znj. Rovena Karçini nga te punesuarit ne shoqeri, si anetare e

Keshillit Mbikqyres.
Per rrjedhoje Keshilli Mbikqyres perbehet nga:

- Z. Skender Amoniku
- Z. Jeffery T. Griffin
- Znj. Rovena Karçini.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres ne mbledhjen e dates 24.12.2003 zgjodhen nga gjiri i tyre ne detyren e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres z.Skender Amoniku dhe ne detyren anetareve Z. Jeffery T. Griffin dhe Znj. Rovena Karçini.
Gjithashtu, ne mbledhjen e po kesaj date Keshilli Mbikqyres vendosi te emeroje Z. Ilir Karcini ne detyren e Drejtorit te shoqerise GLOBAL GAZ SHA., ne vend te Z. Skender Amoniku i cili ka dhene dorehoeqjen.
Me kerkesen drejtuar gjykates se Shkalles se Pare ,kerkoj depozitimin e vendimeve te mesiperme te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise Global Gaz sh.a date 24.12.2003,vendimit te Keshillit mbikqyres date 24.12.2003, vendimit te Fondit date 20.12.2003 prane Zyres se Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktet e shoqerise .

KERKUESI
Ilir KARCINI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR 37 REP NR ~~KOL~~**

## VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 08/01/2004 para meje noteres Dhimitra Qarri,anetare e Dhomes se Noterise Tirane,u paraqit personalisht : Ilir Karcini,i biri i Nisit, datlindja 1969, banues ne Tirane , drejtori i pergjithshem i shoqerise „GLOBAL GAZ" sh.a,i njohur personalisht prej meje noteres i cili me vullnet te lire e te plote deklaroi se sa me siper eshte perpiluar prej tij jashte kesaj zyre noteriale, e nenshkruan ne pranine time dhe une noterja e vertetoj ate konform ligjit .

NOTER

PULLE TAKSE
100 LEKE

**SHOQERIA "GLOBAL-GAZ" SH.A.**
**FIER**

## VENDIM Nr.3

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "GLOBAL-GAZ"SH.A.

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise "GLOBAL-GAZ "SH.A.. e mbledhur sot me daten 16.03.2003 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga drejtori i pergjithshem i saj z.Skender Hamoniku per zmadhim te kapitalit me ane te kontributeve ne natyre nga aksioneret z.Skender Hamoniku, z.Ilir Karcini sipas raportit te vleresimit te eksperteve te kontributeve.

KONSTATOI SE:

Me Vendimin nr.2 date 15.12.2002 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "GLOBAL-GAZ"SH.A. jane miratuar kerkesat e ortakeve per zmadhim te kapitalit te shoqerise sipas perqindjeve te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise dhe rritjen e vleres nominale te aksioneve ekzistuese, dhe konkretisht:
1-z.Skender Haminiku me pjesemarrje 51 % ose 51 aksione,
2-z.Ilir Karcini me pjesemarrje 49 % ose 49 aksione.

Ne diskutimet e bera nga aksioneret e shoqerise u shprehen per vleresimin e bere nga vleresuesit e pasurive te palujteshme (kontributeve ne natyre) z.Hodo Doce e z.Gjin Pergega sipas raportit te hartuar dhe dokumentacionin baze bashkengjitur ketij raporti per vleresimin te kapitalit qe do te zmadhohet ne formen e kontributeve nga dy aksioneret e shoqerise.
Vleresimi i pasurive te palujteshme eshte bere sipas dy raporteve te vleresimit duke pasur per baze vendonhjen e tyre.
-Raport-vleresimi per pasuri te palujtshme fshati Domje Tirane eshte prej 105.000.000 (njeqintepesemiljon)leke.
-Raport-vleresimi per pasuri te palujtshme fshati Portez Fier eshte prej 48.000.000 (dyzetetetemiljon)leke.
Gjithsej vlera e pasurive te palujtshme te vleresuara nga ekspertet e kontributeve ne natyre eshte prej 153.000.000(njeqintepesedhjetetremiljon)leke.
Per sa me larte ne mbeshtetje te Nenit nr.7 pika 2 te Statutit te Shoqerise te Asamblese se Pergjithshm,e te Aksionereve, Nenit 150, 152, 162 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e aksionereve te shoqerise,

VENDOSI

1.Miratimin e raporteve te vleresimit te kontributeve ne natyre nga ekspertet Ing.Hodo Doce dhe Ing.Gjin Pergega per zmadhim te kapitalit prej 153.000000 leke, pra nga 2.000.000 leke qe ishte te behet prej 155.000.000(njeqintepesedhjetepesemiljon) leke.

2.Miratimin per secilin aksioner te rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese ne proporcion me rritjen e kapitalit.

3.Gjithe dokumentacioni I pregatitur per zmadhimin e kapitalit themaltar ne natyre te Shoqerise"GLOBAL-GAZ"SH.A te depozitohet ne regjistrin tregtar sipas kerkesave te Ligjit ''Mbi Shoqerite Tregtare '' dhe statutit te shoqerise.

Vendimi u muar ne unanimitet nga gjithe aksioneret.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE "GLOBAL-GAZ"SH.A.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR355REP NR/KOL
NOTERE DHIMITRA QARRI

# VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 19.03.2003 para meje noteres Dhimitra Qarri e rregjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane ,me Zyre Noteriale ne Bul "Gjergj Fishta", u paraqiten personalisht "
**Skender Hamoniku**, i biri i Hysenit, datlindja 1964, banues ne Fier, drejtori i pergjithshem i shoqerise „GLOBAL GAZ"
**Ilir Karcini** i biri i Nisit, datlindja 1969,banues ne Tirane ,aksioner i shoqerise "GLOBAL GAZ" sh.a te njohur personalisht prej meje noteres,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte vendim i asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise i mare jashte kesaj Zyre Noteriale, e nenshkruajne ne pranine time dhe une noterja pasi e gjeta konform ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" e vertetoj ate ….




Notere

**SHOQERIA "GLOBAL-GAZ"SH.A.**

**FIER**

# PROCES-VERBAL

I mbjatur sot me daten 16.03.2003 nga sekretari Gezim Hamoniku, lidhur me zhvillimin e mbledhjes Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "GLOBAL-GAZ"SH.A.
Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme e Shoqerise mbahet me daten 16.03.2003, prane zyrave te shoqerise,sipas njoftimit te bere nga drejtori i pergjithshem i Shoqerise,me rend dite per miratimin e raporteve te vleresimit te eksperteve te kontributeve ne natyre per (shtimin) zmadhimin e kapitalit themeltar ne natyre.
Ne mbledhje marrin pjese aksioneret:
1.Skender Hamoniku me pjesemarrje ne kapitalin themeltar prej 51%,
2.Ilir Karcini me pjesemarrje ne kapitalin themeltar prej 49%,

Mbledhja eshte thirrur nga drejtori i pergjithshem z.Skender Haminiku drejtohet nga sekretari z.Gezim Hamoniku i caktuar nga drejtori i shoqerise.
Ne mbledhje u shqyrtuan dy raportet e paraqitura nga vleresuasuesit e pasurive te palujteshme si dhe dokumentacioni bashkangjitur ketij raporti per zmadhimin e kapitalit themeltar pa ndryshuar kuotat e pjesemarrjes ne kapital per secilin aksioner dhe per rritjen e vleres nominale te aksioneve ne menyre proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise, si dhe u diskutua nga te gjithe pjesemarresit ne mbledhje lidhur me kete ceshtje.
Aksioneret diskutuan qe zmadhimi I kapitalit themeltar do te jete gjithsej ne shumen prej 153.000.000 leke I cili do te jete per vleren e pasurive te palujtshme ne fshatin Domje Tirane prej 105.000.000 leke si dhe per vleren e pasurive te palujtshme ne fshatin Portez Fier prej 48.000.000 leke.

Secili prej aksionereve u shpreh per zmadhimin (shtimin) e kapitalit themeltar, per rritjen e vleres nominale te aksioneve sipas raporteve te eksperteve per vleresimin e kontributeve te aksionereve ne shoqeri.
Ne mbledhje u vendos qe shoqeria "GLOBAL-GAZ"SH.A.te rrise kapitalin themeltar nga 2.000.000 leke ne 155.000.000 leke, ku secili prej aksionereve te zoteroje:
1-aksioneri Skender Hamoniku zoteron 51 aksione,ose 79.050.000(shtatedhjetenente-miljonepesedhjetmije)leke,
2-aksioneri Ilir Karcini zoteron 49 aksione, ose 75.950.000(shtatedhjetepesemiljone-nenteqintepesedhjetmijeleke,

Vendimi qe mori Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerev te Shoqerise u kalua per votim dhe me unanimitet te plote nga aksioneret pjesemarres u be miratimi i raporteve te paraqitura nga vleresuesit e kontributeve per zmadhimin e kapitalit dhe mos ndryshimin e numerit te aksioneve qe zoteron secili aksioner ne kapitalin themeltar te shoqerise si dhe u miratua dhe rritja e vleres nominale te nje aksioni ekzistues.

Rezultati i votimit eshte:
Moren pjese ne votim 2 aksionere me te drejte vote te barabarte me pjesemarrjen ne kapitalin themeltar te shoqerise .
Votuan dy aksionere me 100 vota gjithsej.

Fier, me 16.03.2003

SEKRETARI

Gezim Hamoniku

DREJTUESI

Skender Hamoniku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR758REP NR KOL
NOTERE DHIMITRA QARRI

VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 19.03.2003 para meje noteres Dhimitra Qarri e rregjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane ,me Zyre Noteriale ne Bul "Gjergj Fishta", u paraqiten personalisht "

**Skender Hamoniku**, i biri i Hysenit, datlindja 1964, banues ne Fier, drejtori i pergjithshem i shoqerise „GLOBAL GAZ"

**Ilir Karcini** i biri i Nisit, datlindja 1969,banues ne Tirane ,aksioner i shoqerise "GLOBAL GAZ" sh.a te njohur personalisht prej meje noteres,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte procesverbal o mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise i mbajtur jashte kesaj Zyre Noteriale, e nenshkruajne ne pranine time dhe une noterja pasi e gjeta konform ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" e vertetoj ate ….

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

Notere

24922/2
01.04.2003

13.02.2003

# K E R K E S E

**Kerkuesit**: Z.Skender Hamoniku I biri I Hysenit, lindur me 1964 ne Fier dhe banues ne Fier, drejtore I pergjithshem te Shoqerise pa oferte publike **"GLOBAL-GAZ"SH.A.**

Objekti:Kerkojme depozitimin ne regjistrin tregtar prane asaj gjykate te Vendimit Nr.2, date 15.12.2002 te Asamnblese se Jashtezakonshme te Shoqerise pa oferte publike **"GLOBAL-GAZ"SH.A.** per emrimin e eksperteve per vleresimin e kontributeve ne natyre per shtimin e kapitalit te shoqerise, si dhe emrimin e ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise, ne baze te Ligjit Nr.7667,date 28.01.1993"Per regjistrin tregtar dhe..."

Gjykates se Rrethit
**<u>T i r a n e</u>**

Me Vendimin Nr.2 date 15.12.2002 te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve te Shoqerise **"GLOBAL-GAZ"SH.A.**

**eshte vendosur:**

Miratimi I z.Gjin Pjetri (Pergegaj)me Licence Nr.005 dhe z.Hodo Doce me Licence Nr.0147 si eksperte per vleresimin e kontributeve ne natyre, per shtim te kapitalit themelatr te shoqerise sipas vleresimit nga ekspertet pa ndryshuar perqindjet e pjesemarrjes ne kapital te aksionereve.
Miratimi I znj.Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar e shoqerise me Licence Nr.24, date 10.02.2000.
Per sa siper kerkojme emerimin e z.Gjin Pjetri (Pergegaj) e z.Hodo Doce per vleresimin e kontributeve ne natyre, emrimin e znj.Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar e shoqerise, si dhe vendimet e marra ne Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve te Shoqerise **"GLOBAL-GAZ"SH.A.** te depozitohen ne regjistrin tregtar te gjykates.

Ju lutemi te merrni ne konsiderate kerkesen
Fier,me 03 Shkurt 2003

Të depozituar kërkesa dhe aktet
Tiranë më 03.03.2003

**Drejtori i Pergjithshem iShoqerise**
**"GLOBAL-GAZ" SH.A.**

**Skender HAMONIKU**

GLOBAL - GAZ SH.A.

— Vendim Nr. 2 dt 15.12.2002
i Asamblesë së Jashtëzakonshme
të aksionerëve Nr. 760 Rep
Not. Qerosi.

**SHOQERIA"GLOBAL- GAZ " SH.P.K** **Tirane me 15.12.2002**

---

# V E N D I M nr 2

## I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE

Sot ne daten 15.12.2002 asambleja e Jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise anonime " GLOBAL-GAZ" **sh.a**

## K O N S T A T O I

Se shoqeria anonime „ GLOBAL-GAZ " **SH.A eshte** rregjistruar Person Juridik me vendimin e Gjykates Se Rrethit Tirane NR 24922 date 11.01.2001,me drejtor te pergjithshem z. Skender Hamoniku ,seli ne Rr Mujo Ulqinaku"Lagja 8 Shkurti"Fier,me kapital themeltar 2 000 000 leke ,me objekt te veprimtarise ,tregetimi ,transportimi i naftes, gazit, dhe nenprodukteve te saj si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme dhe e nevojshme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ne kundershtim me me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Aktualisht si rezultat i zhvillimit te aktivitetit te shoqerise kapitali i saj eshte zmadhuar per sejcilin aksioner ne perputhje me perqindjen qe zoteron sejcili ne kete shoqeri.Ky zmadhim i kapitalit dhe rritja e vleres nominale per sejcilin aksion nuk eshte pasqyruar ne aktet e shoqerise.Ne baze te ligjit 7638 „Per shoqerite tregetare „ date 19.11.1992 e 7667 „Per rregjistrin Tregetar „, dhe statutit Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve e perbere nga askioneret Skender Hamoniku dhe Ilir Karcini me unanimitet :

## VENDOSI

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga kontributet ne natyre.
2. Miratimin e eksperteve Gjin Pjetri (Pergegaj) me nr licence 0005 dhe Hodo Doce me licence nr 0147 te cilet do te kryene raportin e ekspertimit per zmadhimin e kapitalit.
3. Pergatitjen e te gjithe dokumentacionit per zmadhimin e kapitalit themeltar nga kontributet ne natyre te aksionereve te shoqerise „"GLOBAL GAZ" sh.a sipas kerkesave te ligjit „Mbi shoqerite Tregetare" dhe Statutit te shoqerise.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
5. Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise .

AKSIONERET

ILIR KARCINI

GLOBAL - GAZ SH.A

Skender Hamoniku

24922/2 31.03.2003

Z Sollaku 18.03.2003

# KERKESE

**Kerkuesi**: Z.Skender Hamoniku I biri I Hysenit, lindur me 1964 ne Fier dhe banues ne Fier, drejtore I pergjithshem te Shoqerise pa oferte publike **"GLOBAL-GAZ"SH.A.**

Objekti:Kerkojme depozitimin ne regjistrin tregtar prane asaj gjykate te te procesverbalit dhe Vendimit Nr.3, date 16.03.2003 te Asamnblese se Jashtezakonshme te Shoqerise pa oferte publike **"GLOBAL-GAZ"SH.A.** per zmadhim kapitali, ne baze te Ligjit Nr.7667,date 28.01.1993"Per regjistrin tregtar dhe…"

Gjykates se Rrethit
**Tirane**

Ne mbledhjen e dt. 16.03.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise **"GLOBAL-GAZ"SH.A.**

**eshte vendosur:**

Zmadhimi I kapitalit themelatr te shoqerise prej **153.000.000 leke**, I cili ishte **2.000.000 leke** te behet **155.000.000 leke** dhe vlera nominale e nje aksioni ekzistues ne proporcion me rritjen e kapitalit te shoqerise.

Per sa siper kerkojme qe vendimet e marra ne Asamblene e Jashtezakonshme te Shoqerise **"GLOBAL-GAZ"SH.A.** te depozitohen ne regjistrin tregtar te gjykates.

Bashkelidhur ju paraqesim dokumentet e nevojshme.

Fier,me 17 Mars 2003

**Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise**
**"GLOBAL-GAZ" SH.A.**

**Skender HAMONIKU**

Të depozitohet kërkesa dhe aktet. Tiranë më 31.03.2003 Sollaku Gjyqtare Regjire Sollaku

- Raport Vlerësimi i ekspertëve H. Soce e Gj. Pargesa dt. 10.03.2003.
- Proces - Verbal i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve Nr. 759 Rep.
- Vendimi Nr 3 i Asamblesë së Jashtëzakonshme Aksionarëve dt. 16.03.2003 Nr. 355 Rep.

Not. Xh. Qarri

24922

# KERKESE

KERKUESIT :Z. SKENDER HAMONIKU ,I biri I HYSENIT dhe ibiri i LIRIS lindur me FIER ne dt.15/08/1964 ,banues ne FIER me adrese LAGJA "8 SHKURTI " me pashaporte nr.0097755,shtetas Shqiptare.

Z. ILIR KARCINI I biri i NISIT dhe i VANGJELIS lindur ne FIER ne dt.02/11/1969 , banues ne FIER me adrese LAGJA "1 MAJ"me pashaport nr.1501350,Shtetas shqiptare.

, me zotesi te plote juridike per te vepruar KERKOJNE:

OBJEKTI: Regjistrimin si Person Juridik te shoqerise anonime GLOBAL – GAZ sh.a ne mbeshtetje te ligjit 7632 dt.04.11.1992 dhe Ligjit nr.7667 date 28.01.1993.

PERPARA: GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Me kapitalet qe Z.SKENDER HAMONIKU ,Z.ILIR KARCINI kane themeluar GLOBAL GAZ sh.a. me Drejtor te Pergjithshem SKENDER HAMONIKU me kapital 2 000 000 leke,me kohezgjatje aktiviteti mbi 10 vjet, me adrese lagja :8 Shkurti rruga Mujo Ulqinaku FIER.

iii. Albanian-American Enterprise Fund, 12 shares.

B. According to the Company Shareholders' Resolution dated 11 November 2004, the Seller and Buyers have agreed the Seller to sell out totally its equity in the Company and the Company to pay all the loan that the Seller made to the Company pursuant the Loan Agreement assigned no. 477 rep., no. 1062 col., dated 26 August 2003 as amended by the Agreement assigned no. 7513 rep., no. 1938 col., dated 24 December 2003. A separate agreement shall be entered between the Seller and the Company for repayment of the said loan.

C. Seller is willing to sell to the Buyers and Buyers are willing to acquire the following number of shares from the Seller's Shares identified in paragraph (A) above:

i. Mr. Skender Amoniku 5 shares;

ii. Mr. Ilir Karçini 7 shares.

NOW, THEREFORE, in consideration for the mutual agreements contained herein the parties agree as follows:

ARTICLE 1
PURCHASE AND SALE OF SHARES

Subject to the provisions of this Agreement, the Seller hereby sells to Buyers and Buyers purchase from the Seller all the Seller's Shares, from which 5 (five) shares buys Mr. Skender Amoniku and 7 (seven) shares buys Mr. Ilir Karçini, for the total purchase price of US$ 340,000 (three hundred forty thousand US dollars). This amount, as may be adjusted according to art. 2.2 below, will hereinafter be referred to as the "Purchase Price".

ARTICLE 2
PURCHASE PRICE AND MODALITY OF PAYMENT

2.1 Buyers shall pay to Seller the Purchase Price immediately after signature of this Agreement but not later than 31 December 2004, by check of wire deposit into the Seller's bank account at the American Bank of Albania, in immediately available funds. Buyers shall be severally and jointly responsible for payment of the entire Purchase Price to the Seller. Buyers shall bear all foreign exchange risks and all foreign

exchange expenses in connection with its making payments in United States dollars as required hereunder.

2.2 The Purchase Price payable by the Buyers to the Seller shall be subject to the following adjustments in case of Buyers failure to pay to the Seller by 31 December 2004:

(i) If Buyers will make the payment during January 2005, an amount of US$ 10,000 (ten thousand US dollars) will be added and the entire Purchase Price payable will become US$ 350,000 (three hundred fifty thousand US dollars);

(ii) If Buyers will make the payment during February 2005, an amount of US$ 10,000 (ten thousand US dollars) more than that of (i) above, will be added and the entire Purchase Price payable will become US$ 360,000 (three hundred sixty thousand US dollars;

(iii) If Buyers will make the payment during March 2005, an amount of US$ 10,000 (ten thousand US dollars) more than that of (ii) above, will be added and the entire Purchase Price payable will become US$ 370,000 (three hundred seventy thousand US dollars.

2.3 Delay of the Buyers after 31 March 2005, in payment of the Purchase Price as adjusted according to paragraph 2.2 above, entitles the Fund:

(i) to declare then the outstanding amounts, under this Share Purchase Agreement and the Agreement for repayment of the loan to be entered between the Company and the Fund (paragraph B above), to be forthwith due and payable in whole or in part, and all other liabilities of the Buyers and the Company accrued hereunder, shall become forthwith due and payable, without presentment, demand, protest or any other notice of any kind, all of which are hereby expressly waived by the Buyers; and

(ii) initiate claims under all the guaranties granted to the Seller under the Equity Investment Agreement assigned no. 3481 rep., no. 835 col., dated 12 June 2003, as amended by the Agreement assigned no. 7512 rep., no. 1937 col., dated 24 December 2003, the Put Option Agreement assigned no. 7514 rep., no. 1939 col., dated 24 December 2003, the Loan Agreement assigned no. 477 rep., no. 1062 col., dated 26 August 2003, as amended by the Agreement assigned no. 7513 rep., no. 1938 col., dated 24 December 2003, without any prejudice to the right of the Fund to exercise any and all remedies for repayment provided by the law.

2.4 Any and all payments by the Buyers shall be made free and clear of and without deduction for any and all taxes. If Buyers shall be required by law to deduct any taxes or other fees from or in respect of any sum payable, (i) the sum payable shall be increased by the amount necessary so that after making all required deductions (including deductions applicable to additional sums payable under this paragraph) the Seller shall receive an amount equal to the sum it would have received had no such deductions been made, (ii) Buyers shall make such deductions and (iii) Buyers shall pay the full amount deducted to the relevant Governmental Authority in accordance with applicable law. In addition, Buyers agree to pay any present or future stamp or recording taxes related to delivery or registration of this Contract.

2.5 Upon full payment of the Purchase Price as may be adjusted under paragraph 2.2 above or remedied under paragraph 2.3 above, Seller shall lose any right of property or dividend on the Company and the Buyers shall be the sole and lawful owner of the shares subject to this Agreement.

ARTICLE 3
REPRESENTATIONS AND WARRANTIES

3.1 Seller represents and warrant that: (i) it is a Not-for-Profit corporation duly organized, validly existing under the laws of the State of Delaware, USA; (ii) Seller has fully subscribed and paid in the Seller's Shares (iii) this Agreement constitutes a legal, valid, binding and enforceable obligation of the Seller.

3.2 Buyers represent and warrants that: (i) Buyers are in full possession of their capacity to act and understand; (ii) Buyers being shareholders of the Company are fully aware of the Company financial and economical conditions and therefore accept the Seller's Shares without any claim; (iii) Buyers will make any payment according to this Agreement with funds deriving from their lawful businesses and from declared sources; (iv) the execution, delivery and performance of this Agreement by the Buyers has been duly performed and will not violate any law, any order of any Governmental Authority; (v) this Agreement has been duly executed and constitutes a legal, valid and binding obligation of the Buyers, enforceable against the Buyers and their successors in accordance with its terms (vi) the current Bylaws of the Company and composition of the Company's bodies shall remain unchanged until the Buyers and the Company pay all debts to the Fund pursuant to this Share Purchase Agreement and the agreement to be entered between the Company and the Fund for repayment of the loan (paragraph B above).

ARTICLE 4
MISCELLANEOUS

4.1 This Agreement, executed in five copies in English language and five copies in Albanian language, constitutes the entire agreement between the parties, and all promises, representations, understandings and agreements with reference to the subject matter hereof relied upon by any party hereto have been expressed. No modification to this Agreement shall be valid unless mutually agreed between the parties and confirmed by a written amendment signed by their authorized representatives. This Agreement supersedes the Equity Investment Agreement assigned no. 3481 rep., no. 835 col., dated 12 June 2003, as amended by the Agreement assigned no. 7512 rep., no. 1937 col., dated 24 December 2003, the Put Option Agreement assigned no. 7514 rep., no. 1939 col., dated 24 December 2003, provided that all guaranties given by the Buyers to the Seller shall remain equally valid to secure performance of obligation undertaken by the Buyers pursuant to this Agreement. In addition, all guaranties granted to the Seller by the Company under the Loan Agreement assigned no. 477 rep., no. 1062 col., dated 26 August 2003, as amended by the Agreement assigned no. 7513 rep., no. 1938 col., dated 24 December 2003, shall remain valid and shall secure also performance of the obligations the Buyers have undertaken herein.

4.2 The Seller shall release all the guaranties mentioned here above only after the Buyers have fully paid to the Fund all and any amount payable according to this Agreement and the agreement to be entered between the Seller and the Company pursuant to paragraph (B) here above which shall include full repayment of any loans outstanding made by the Seller to the Company and all accrued interest.

ARTICLE 5
GOVERNING LAW AND DISPUTES

5.1 Questions concerning matters arising under but not settled in this Agreement shall be settled in conformity with the laws of the Republic of Albania, which shall be applicable to this Agreement.

5.2 Any disputes arising between the parties hereto in respect of this Agreement that will not be resolved in negotiations between them, shall be subject to the decision of the First Instance Court of Tirana which decision might be appealed under the provisions of the Albanian Code of Civil Procedure.

IN WITNESS WHEREOF, I the undersigned Notary Public hereby read in laud voice all the above to the representatives of the parties hereto. Mr. Jeffrey T. Griffin, being assisted by the

translator recognized by me Notary Public and accepted by M. Griffin, Mr. Skender Amoniku and Mr. Ilir Karçini declared to me that they understand the content of this Agreement, and as far as it express their free and full will, they signed it in front of me Notary Public.
Given under my seal and signature in compliance with the laws of the Republic of Albania this ___th day of November 2004.

SELLER
For and on behalf of:
ALBANIAN AMERICAN
ENTERPRISE FUND

Mr. Jeffrey T. Griffin
CEO and President

F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA

BUYERS

Mr. Skender Amoniku

Mr. Ilir Karçini

NOTARY PUBLIC

NOTERE
ARJANA R. MALLKUÇI
Tel Zyre 250253,266242

TRANSLATOR

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 5550 Regj.
Vërtetohet fotokopja
me origjinalin
NOTERE TIRANE 23-11-2004
ARJANA R. MALLKUÇI
Tel Zyre 250253,266242

**MARREVESHJE**
**PER NDRYSHIMIN E**
**MARREVESHJES SE INVESTIMIT**

Ne Tirane, sot me date 24 Dhjetor 2003, midis:

**Z. Skender Amoniku**, shtetas shqiptar, lindur ne Fier me 15 gusht 1964, mbajtes i pasaportes nr. Z 0057810, banues ne Fier;

**Mr. Ilir Karçini**, shtetas shqiptar, lindur ne Fier me 2 nentor 1969, mbajtes i pasaportes nr. 1501350, banues ne Tirane; Me poshte secili prej tyre i quajtur "Aksionar" dhe bashkerisht "Aksionaret";

**GLOBAL GAZ SHA.**, shoqeri anonime e kriuar sipas legjislacionit shqiptar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), me seli ne Fier, e rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar nepermjet vendimit nr. 24922, date 11 Janar 2001, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, e perfaqesuar ne kete marreveshje nga Z. Skender Amoniku, Drejtor i Shoqerise;

**Dhe**

**FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE (AAEF)**, organizate pa qellim fitimi, rregjistruar ne shtetin Delaware, SHBA, me perfaqesine e saj ne adresen "Green Park Complex", Kulla II, Kati XII, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga Z. Aleksander Sarapuli, i autorizuar me prokuren Nr. 805 Rep., Nr. 74 Kol., date 11 Shtator 2002 (qe me poshte do te quhet "Fondi");

Lidhet kjo **MARREVESHJE PER NDRYSHIMIN** (qe me poshte do te quhet "Ndryshimi") e MARREVESHJES SE INVESTIMIT date 12 Qershor 2003, nr. 3481 rep., nr. 835 kol. (me poshte "Marreveshja e Investimit").

**HYRJE**

A. Palet kane lidhur Marreveshjen e Investimit nr. 3481 rep., no. 835 kol., date 12 Qershor 2003,

B. Fondi dhe Shoqeria kane nenshkruar nje Mareveshje Huaje nr. 477 rep., nr. 1062 kol., date 26 Gusht 2003 ("Mareveshja e Huase (A)"), sipas afateve dhe kushteve te se ciles, Fondi, ne date 18 Shtator, 2003 ("Data e Levrimit") ka levruar ne favor te Shoqerise nje hua ne shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US).

C. Fondi dhe Shoqeria bien dakord te ndryshojne kushtet e dhe afatet e Marreveshjes se Huase (A) dhe te konsiderojne shumen e levruar sipas Marreveshjes se Huase (A) si pjese te

Principalit te Huase US$ 676.328.00 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US) te parashikuar ne paragrafin C te Hyrjes se Marreveshjes se Investimit.

D. Fondi dhe Shoqeria kane rene dakord qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit huane US$ 676.328.00 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US) ne te cilen perfshihet edhe shuma e levruar US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US), sipas kushteve te parashikuara me poshte ne kete Ndryshim.

E. Shoqeria, nepermjet vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionarev date 24 Dhjetor 2003, dhe ne perputhje me Marreveshjen e Investimit, ka emetuar 12 (dymbedhjete) aksione te reja te kapitalit te shoqerise me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) secili, duke zmadhuar Kapitalin e Shoqerise ne Leke 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milione e gjashteqind mije) ("Kapitali 1"). Ne te njejten mbledhje te Asamblese se Aksionareve, Aksionaret hoqen dore nga e drejta e nenshkrimit te ketyre aksioneve te reja.

F. Sipas Marreveshjes se Investimit, nepermjet nenshkrimit te ketij Ndryshimi, Fondi nenshkruan 12 aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria dhe bie dakord te shlyeje çmimin e ketyre aksioneve te reja per shumen US$ 292.208 (dyqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US).

G. Fondi eshte dakort t'i jape Shoqerise dhe Shoqeria e aurtorizuar nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve e dates 24 Dhjetor 2003, eshte dakort qe te marre nga Fondi, nje hua te konvertueshme (qe me poshte do te quhet "Huaja"), sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:

(i) Principal i Huase do te jete US$ 676.328.00 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US), prej te cilave Fondi ka levruar ne favor te Shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjete mije dollare US) sipas Marreveshjes se Huase (A);

(ii) Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane brenda 5 vjeteve; Principali do te filloje te paguhet pas dates 31 Janar 2005 dhe pagesat e Principalit do te jene ne keste tre mujore duke filluar nga 18 Marsi 2005;

(iii) Interesi qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit eshte 12% ne vit; interesi do te paguahet çdo tre muaj dhe do te llogaritet duke filluar nga data 18 Shtator, 2003 per nje periudhe 5 vjeçare;

(iv) Huaja do te konsiderohet si nje Hua e shkalles se dyte, ne rast se Shoqerise do t'i jepet hua nga nje banke tjeter deri ne vleren e principalit prej 1,000,000.00 USD (nje million dollare), pasi Fondi te jete siguruar qe asnje hua tjeter nuk eshte rregjistruar pas asaj te dhene nga Fondi;

(v) Nese Fondi eshte dakord, Huaja mund te konvertohet ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne kete Marreveshje. Huaja mund te konvertohet ne aksione te reja vetem brenda nje afati prej nje viti qe fillon ne date 18 Shtator, 2003 (Data e Levrimit) dhe perfundon ne date 18 Shtator 2004. Megjithate, Fondi ka te drejte te marre vendim nese do te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te shoqerise brenda dates 31 janar 2005, pasi Shoqeria dhe aksionaret e saj t'i kene vene ne dispozicion te gjithe informacionin financiar e kerkuar nga Fondi per vitin financiar 2004 ne lidhje me aktivitetin e LPG-se (ku LPG do te kuptohet gazi i lengshem) te vete Shoqerise, si dhe te subjekteve te tjera ne te cilat Shoqeria ose aksionaret e saj kane pjesemarrje direkte ose indirekte (me poshte "Aktiviteti i Pergjithshem i LPG-se"). Nese deri ne date 31 Janar 2005, Fondi nuk ka vendosur te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, interesi i Huase qe Shoqeria do t'i paguaje Fondit do te ulet ne 9% ne vit. Ky efekt i zvogelimit te interesit te Huase do te filloje nga data 18 Shtator 2004 dhe pagesa e interesit qo duhet te behej sipas rradhes ne muajin Dhjetor 2004 do te kryhet se bashku me kestin pasardhes te interesit ne diten perkates te muajit Mars 2005.

Nese Fondi vendos te konvertoje Huane ne aksione te reja te kapitalit te Shoqerise, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise duhet te vendose zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise 1, nepermjet emetimit te 33 aksioneve te reja dhe vlera e ketij konvertimi do te jete 6 here mesatarja e 2001/2002 EBITDA (ku EBITDA do te thote e ardhur perpara interesit, tatim fitimit e amortizimit per Aktivitetin e Pergjitshem te LPG-se).

H. Fjalet qe fillojne me shkronje te madhe e qe nuk jane te shpjeguara ne kete marreveshje, do te kene kuptimin e treguar ne Aneksin A te Marreveshjes se Investimit.

**DUKE PATUR PARASYSH SA ME LART, PALET BIEN DAKORD SI VIJON:**

SEKSIONI 1.01

a. Emetimi dhe Nenshkrimi i Aksioneve te Reja

Shoqeria, nepermjet vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve date 24 Dhjetor 2003, dhe ne perputhje me Marreveshjen e Investimit, ka emetuar 12 (dymbedhjete) Aksionet e Reja te Fazes se Pare me vlere nominale Leke 1.550.000 (nje milion e peseqind e pesedhjete mije) secili, duke zmadhuar Kapitalin e Shoqerise ne Leke 173.600.000 (njeqind e shtatedhjete e tre milione e gjashteqind mije) ("Kapitali 1").

Sipas Marreveshjes se Investimit, nepermjet nenshkrimit te ketij Ndryshimi, Fondi nenshkruan 2 Aksionet e Reja te Fazes se Pare te emetuara nga Shoqeria dhe bie dakord te shlyeje Çmimin e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare sipas dispozitave te parashikuara me poshte ne paragrafin (b) te ketij Seksioni 1.01.

b. <u>Shlyerja e Çmimit te Aksioneve te Reja</u>

Fondi do te depozitoje Çmimin e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, ne shumen US$ 292.208 (dy qind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US), menjehere pas Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, ne nje llogari bankare "*escrow*" te veçante ne emer te Shoqerise e te Fondit (dhe nga ku mund te terhiqen vetem me firme te perbashket te Fondit dhe te perfaqesuesit te Shoqerise). Kjo shume mund te terhiqet menjehere pas marrjes se vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per njohjen e zmadhimit te Kapitalit te Shoqerise ne nivelin e Kapitalit I dhe hyrjen e Fondit ne Shoqeri si aksionar.

**SEKSIONI 2.01**

a. <u>Huaja</u>

Ne baze te kushteve dhe mbeshtetur tek perfaqesimet dhe garancite e percaktuara ne Marreveshjen e Investimit dhe Marreveshjes se Huase (A), Fondi pranon t'i jape hua Shoqerise, ne shumen US$ 676,328 (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezete e tete dollare US) (me poshte "Principali").

Fondi, ne date 18 Shtator 2003, ka levruar ne favor te Shoqerise shumen US$ 450.000 (katerqind e pesedhjetemije dollare US) nga Principali sipas Marreveshjes se Huase A te permendur ne paragrafin (B) te Hyrjes me siper.

Pasi te jene permbushur kushtet e parashikuara me poshte ne paragrafin (e) te ketij Seksioni, Fondi eshte dakort te levroje ne favor te Shoqerise shumen US$ 226.328 (dyqind e njezete e gjashte mije e treqind e njezete e tete dollare US) ne nje shume te vetme brenda nje muaji nga data e nenshkrimit te kesaj marreveshje, date e cila do te quhet me poshte "Data e Fundit e Levrimit".

(b) Pagesat.

Shoqeria do t'i ktheje Fondit Huane brenda nje afati 5 vjeçar. Principali do te filloje te paguhet pas dates 31 Janar 2005. Pagesa do te behet ne keste tre mujore duke filluar nga data 18 Mars 2005.

Shoqeria do t'i paguaje Fondit interes ne masen 12% (dymbedhjete perqind) ne vit ("Perqindja e Interesit") i llogaritur mbi Principalin duke pasur parasysh ditet aktuale dhe nje baze vjetore prej 360 ditesh. Pagesa e interesit do te behet ne keste tre mujore.

Ne rast se Shoqeria vonohet ne pagesen e interesit apo ndonje shume tjeter te pagueshme sipas kesaj Marreveshje, Shoqeria duhet t'i paguaje Fondit nje penalitet ne shumen US$ 1,000 (njemije dollare US), si dhe nje interes 4 % ne vit me i madh se Perqindja e Interesit llogaritur mbi shumen per te cilen Shoqeria eshte ne vonese do te aplikohet mbi Shoqerine per çdo dite vonese nga data kur shuma perkatese duhej te ishte paguar.

Shoqeria duhet te kryeje çdo pagese te Principalit, interesave apo çdo shume tjeter, ne Dollare Amerikane. Pagesa do te behet me çek ose transferte ne llogarine bankare te Fondit prane Bankes Amerikane te Shqiperise, ne fonde menjehere te perdorshme. Shoqeria do te perballoje te gjithe rreziqet dhe shpenzimet e rrjedhura nga kursi i kembimit te valutes se huaj si pasoje e kerkeses se percaktuar ne kete marreveshje per realizimin e pagesave ne US Dollare.

(c) Parapagimi. Shoqeria ka te drejte te qe te paguaje pjeesrisht apo teresisht Principalin dhe/ose interesat ne çdo kohe perpara afatit. Çdo parapagim i Principalit dhe interesave te maturuar ne daten e parapagimit nuk mund te jete me i vogel se US$ 20,000 (njezete mije dollare US).

(d) Tatimet. Te gjitha pagesat e Huase nga Shoqeria do te behen duke qene te perjashtuara, dhe pa zbritje, nga te gjitha llojet e Tatimeve. Neqoftese Shoqeria eshte e detyruar sipas ligjit te zbrese çdo lloj Tatimi nga, ose ne lidhje me çdo shume te pagueshme, (i) shuma e pagueshme do te shtohet me shumen e nevojshme ne masen qe, pasi behen te gjitha zbritjet e detyrueshme, (duke perfshire zbritjet e aplikuara ne shumat shtese te pagueshme sipas ketij paragrafi) Fondi te marre nje shume te barabarte me shumen qe duhej te merrte ne rastin kur zbritje te tilla nuk do te beheshin, (ii) Shoqeria duhet t'i beje zbritje te tilla dhe (iii) Shoqeria duhet t'i paguaje te gjithe shumen e zbritur Autoritetit Publik perkates sipas ligjit qe zbatohet ne kete rast.

(d) Garancite

Te gjitha Garancite qe Shoqeria i ka dhene Fondit sipas termave dhe kushteve te Seksionit 3.01/a te Marreveshjes se Huase (A), do te ngelen ne fuqi dhe te pandryshuara per te siguruar pagesat e Principalit, interesave dhe çdo shume tjeter te pagueshme nga Shoqeria per Fondin sipas ketij Ndryshimi.

Shoqeria duhet te kete pergatitur dhe t'i dorezoje Fondit nje hipoteke te shkalles se dyte te pasurive te paluajtshme te Shoqerise per te garantuar permbushjen e te gjitha detyrimeve qe permenden ne kete Ndryshim.

Nese Shoqeria nuk do t'i paraqese Fondit Garancite e siperpermendura sipas paragrafeve te mesiperme, Shoqeria duhet t'i ktheje Fondit shumen e Huase se levruar sipas termave dhe kushteve te Marreveshjes se Huase (A).

SEKSIONI 3.01

Konvertimi i Huase ne Aksione

(i) Fondi eshte i lire dhe ka te drejte te vendose nese do ta konvertoje Huane ne aksione te reja te Kapitalit 1 te Shoqerise deri ne daten 31 Janar 2005. Nese Huaja do te konvertohet ne Aksione, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise duhet te vendose per zmadhimin e Kapitalit 1 nepermjet emetimit te 33 aksioneve te reja dhe vlera e ketij konvertimi do te jete 6 here mesatarja 2001/2002 EBITDA (ku EBITDA do te thote e ardhur perpara interesit, tatim fitimit e amortizimit per Aktivitetin e Pergjithshem te LPG-se).

Nenshkrimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte do te konsiderohet njoftimi me shkrim qe Fondi do t'i beje Shoqerise, pas konvertimit te Huase dhe kjo do te quhet "Nenshkrimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte", ndersa data do te quhet "Data e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte".

(ii) Me nenshkrimin e Fazes se Dyte, Aksioneret dhe Shoqeria duhet t'i dorezojne Fondit nje kopje te noterizuar te vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve, ku pranohet emetimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte qe do te nenshkruhen nga Fondi, duke permendur numrin (33) te aksioneve te reja qe do te emetohen dhe vlera e kapitalit te Shoqerise qe do te zmadhohet pas emetimit te tyre, nenshkrimin dhe pagimin e ketyre aksioneve te reja nga Fondi, si dhe te permendet fakti qe aksioneret heqin dore nga e drejta e para blerjes se ketyre aksioneve te reja.

SEKSIONI 4.01

Te ndryshme

Ky Ndryshim do te perbeje nje pjese integrale te Marreveshjes se Investimit. Ne rast te mosperputhjes midis termave dhe kushteve te ketij Ndryshimi me ato te Marreveshjes se Investimit ose te Huase (A), termat dhe kushtet e ketij Ndryshimi kane perparesi.

NE PREZENCE TE, Shoqeria dhe Fondi i kerkojne zbatimin e kesaj Marreveshje oficereve dhe punonjesve respektive te autorizuar si me siper ne daten e nenshkrimit te saj.

ONERET

Skender Amoniku

Ilir Karçini

Global Gaz Sh.A.
Perfaqesuar nga:

Skender Amoniku

FONDI SHQIPTAR AMERIKAN I NDERMARRJEVE
Perfaqesuar me prokure nga

Aleksander Sarapuli

MARREVESHJE INVESTIMI

MIDIS

z. Skënder Hamoniku
z. Ilir Karçini
GLOBAL GAZ SHA.
Shoqeri Anonime e Krijuar sipas Legjislacionit te Republikes se Shqiperise

DHE

FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE
Organizate Jofitimprurese e krijuar sipas Legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A.

---

Date 12 Qershor 2003

---

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 5543 Regj.
Vërtetohet fotokopja
me origjinalin
TIRANE 23.11.2004

NOTERE
ARIANA R. MALLKUÇI
Tel. Zyre 250253,266242

PULLE TAKSE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
100 LEKE
TIRANE

MARREVESHJE INVESTIMI (me poshte e quajtur "Marreveshja"), e lidhur me date _____, midis:

- Z. SKENDER HAMONIKU shtetas _____, lindur ne FIER me 5.8.1964 mbajtes i pasaportes nr. Z 0057810 banues ne adresen: FIER.
- Z. ILIR KARCINI shtetas _____, lindur ne _____ me _____, mbajtes i pasaportes nr. _____, banues ne adresen: _____.

Me poshte secili prej tyre i quajtur "Aksionar" dhe se bashku te quajtur "Aksionare".

- GLOBAL GAZ SHA., shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, (me poshte e quajtur "Shoqeria") e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr 24527 date 11/06/2001 Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me seli ne FIER e perfaqesuar nga SKENDER HAMONIKU

Dhe

FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE, organizate jofitimprurese e krijuar sipas legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A, me seli ne _______, Tirane, Shqiperi, e perfaqesuar nga Z. Jeffrety T. Griffin ne cilesine e Pèrsident & CEO i AAEF (me poshte i quajtur "Fondi").

Aksionaret, Shoqeria dhe Fondi me poshte here pas here do te quhen bashkerisht "Palet".

HYRJE

A. Shoqeria ka nje kapital te nenshkruar dhe te shlyer teresisht nga Aksionaret ne shumen Leke 2.000.000 (me poshte i quajtur "Kapitali"), i ndare ne 100 aksione nga Leke 20.000 (___) secili i zoteruar teresisht nga Aksionaret si me poshte:

| AKSIONARET | AKSIONET |
|---|---|
| S. HAMONIKU | 51 (_%) |
| I. KARCINI | 49 (_%) |
| TOTAL | 100 (100%) |

B. Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise e mbajtur ne date ____, ka autorizuar zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise ne Leke ____ (____) ("Kapitali 1") nepermjet emetimit te 12 ) aksioneve te reja me vlere nominale Leke 20.000 ) secili), dhe i ka njohur Fondit te drejten qe te nenshkruaje dhe shlyeje keto aksione te reja kundrejt vleres US$ 292,208. (dy qind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US). sipas kushteve te kesaj Marreveshje. Kete te drejte, Fondi mund ta ushtroje brenda gjashte muajve kalendarike nga data e nenshkrimit te kesaj Marreveshjeje Investimi. Aksionet e reja qe do te emetohen do te perbejne 10.7% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit per shkak te ketij emetimi. Shoqeria merr persiper te mos zvogeloje Kapitalin e saj apo te kryeje ndonje operacion tjeter qe mund te ndikoje ne vleren dhe te drejtat qe do te gezoje Fondi si zoterues i ketyre aksioneve te reja.

C. Gjithashtu, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise ne te njejten mbledhje te mbajtur ne date _____, ka autorizuar Shoqerine te marre nje hua nga Fondi,

nese Fondi eshte dakord dhe vendos t'i jape hua Shoqerise, ne shumen dhe sipas kushteve e afateve te meposhtme (me poshte e quajtur "Huaja"), e cila mund te konvertohet ne aksione te reja te Kapitalit te Shoqerise, si dhe te jape garanci per shlyerjen e Huase:

(i) Principali i Huase US$ 676,328. (gjashteqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e njezet e tete dollare US).

(ii) Afati i kthimit te Principalit dhe interesave te Huase, 5 vjet kalendarike. Kthimi i Principalit do te filloje pas nje viti nga data e levrimit te Huase dhe do te paguhet ne 16 (gjashtembedhjete) keste te pagueshme çdo tre mujor.

(iii) Interesi vjetor 12%. Do te paguhet ________ duke filluar nga _______

(iv) Shoqeria do vere garanci ne favor te Fondit per shlyerjen e Huase.

(v) Nese Fondi eshte dakord, Huaja mund te konvertohet ne aksione te reja te Kapitalit te Shoqerise sipas kushteve dhe afateve te kesaj Marreveshje. Konvertimi mund te realizohet vetem brenda dy viteve kalendarike nga data e levrimit te Huase. Nese Huaja nuk do te konvertohet ne aksione si me siper, interesi i Huase do te zvogelohet ne 9% duke filluar nga fundi i vitit te dyte pas dates se disbursimit te huase.

Nese Huaja konvertohet ne aksione te reja te Kapitalit te Shoqerise, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise per kete qellim do te marre vendim te zmadhoje Kapitalin e Shoqerise ne momentin e konvertimit (Kapitalin 1) nepermjet emetimit te aksioneve te reja. Numri dhe vlera e aksioneve te reja qe do te emetohen per te konvertuar Huane, do te percaktohet sipas formules: vlera e aksioneve te reja qe emetohen = 6 here 2001/2002 EBITDA (ku 2001/2002 EBITDA do te thote Fitimi Perpara Interesit, Takses dhe Amortizimi mesatar per vitin financiar 2001/202).

D. Fondi deshiron dhe eshte dakord te marre ne konsiderate mundesine e investimit ne Shoqeri ne njeren ose te dyja menyrat e parashikuara ne paragrafin C me siper, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Marreveshje, nese plotesohet kushti qe brenda 6 muajve kalendarike nga data e kesaj Marreveshje te miratohet Plani i Investimit nga Fondi dhe Aksionaret, si dhe kushtet e tjera te kesaj Marreveshje.

E. Termat qe fillojne me shkronje te madhe te cilat jane perdorur me poshte dhe nuk jane shpjeguar, do te kene kuptimin e treguar ne Aneksin A bashkengjitur kesaj Marreveshje.

PALET BIEN DAKORT PER SA VIJON:

SEKSIONI 1.01.

a. Emetimi dhe Nenshkrimi i Aksioneve te Reja.

(i) Shoqeria, me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te dates ______, ka autorizuar zmadhimin e Kapitalit nga ai ekzistues ne ____________ (_______) (Kapitali 1), nepermjet emetimit te 124 ) aksioneve te reja me vlere nominale Leke 20.000) (me poshte te quajtura "Aksionet e Reja te Fazes se Pare").

Aksionaret, nepermjet nenshkrimit te kesaj Marreveshje, heqin dore nga e drejta e tyre e perparesise ne nenshkrimin e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare dhe i njohin Fondit te drejten per te nenshkruar Aksionet e Reja te Fazes se Pare dhe per t'i shlyer ato ne te holla per shumen US$ 292.208 (dy qind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US), (me poshte

e quajtur "Vlera e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare"). Aksionet e Reja te Fazes se Pare do te perbejne 10.7% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit (Kapitalit 1). Fondi eshte i lire te vendose qe, sipas kushteve, afateve, deklarimeve e garancive te parashikuara ne kete Marreveshjeje, pas permbushjes se kushtit te parashikuar ne paragrafin (a.ix) te Seksionit 3.01 me poshte, brenda gjashte muajve kalendarike nga data kesaj Marreveshje, te ushtroje te drejten e tij duke nenshkruar Aksionet e Reja te Fazes se Pare dhe shlyer Vleren e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare.

b. <u>Nenshkrimi i Aksioneve te Reja</u>

(i) Fondi eshte i lire te vendose per te nenshkruar Aksionet e Reja te Fazes se Pare ne çdo moment pas permbushjes se kushtit te percaktuar ne paragrafin (a.ix) te Seksionit 3.01 dhe brenda afatit gjashte mujor te percaktuar ne paragrafin (a) me siper. Fondi do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise vendimin e tij per nenshkrimin e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare. Ky vendim me shkrim i Fondit do te perbeje nenshkrimin e aksioneve te reja dhe do te quhet me poshte "Nenshkrimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Pare", kurse data e ketij vendimi do te quhet me poshte "Data e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare".

(ii) Fondi eshte i lire te vendose brenda ____ nga data e kesaj Marreveshje Investimi, nese do t'i jape Shoqerise Huane sipas kushteve te parashikuara ketu me siper ne pragrafin (C) te Hyrjes. Nese Fondi vendos t'i jape Huane Shoqerise, Fondi dhe Shoqeria do nenshkruajne nje Marreveshje Huaje te veçante ("Marreveshja e Huase") ne te cilen do te perfshihen kushtet e siperpermendura te pragrafit (C).

(iii) Fondi eshte i lire te vendose nese do te konvertojne Huane ne aksione te reja te Kapitalit te Shoqerise sipas kushteve te parashikuara me siper ne paragrafin (C.v) te Hyrjes se kesaj Marreveshje Investimi. Nese Fondi eshte dakord per realizimin e konvertimit, ia ben te ditur me shkrim Shoqerise vullnetin e tij per kete qellim dhe Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise do te marre vendim te zmadhoje Kapitalin e Shoqerise ne momentin e konvertimit (Kapitalin 1) nepermjet emetimit te aksioneve te reja (me poshte te quajtura "Aksionet e Reja te Fazes se Dyte") ne favor te Fondit te cilat do te konsiderohen te nenshkruara e te shlyera nga Fondi. Momenti ne te cilin Fondi njofton me shkrim Shoqerine se eshte dakord per konvertimin e Huase ne Aksione te Reja te Fazes se Dyte te Kapitalit te Shoqerise, do te quhet me poshte "Nenshkrimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte", kurse data e ketij njoftimi do te quhet "Data e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte". Numri i Askioneve te Reja te Fazes se Dyte dhe Vlera e Aksioneve te Reja te Fazes se Dyte do te caktohen sipas menyres se parashikuar ne paragrafin (C.v) te Hyrjes se kesaj Marreveshje.

(iv) Si ne momentin e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare ashtu edhe te Fazes se Dyte, Aksionaret do t'i dorezojne Fondit vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve nepermjet te cilit aprovohet emetimi i aksioneve te reja dhe nenshkrimi i tyre nga Fondi, si dhe ku percaktohet sa do te jete madhesia e Kapitalit te Shoqerise pas nenshkrimit dhe shlyerjes se aksioneve te reja nga Fondi, si dhe te deklaroje se nuk do te zvogeloje Kapitalin e Shoqerise apo te kryeje ndonje operacion tjeter qe mund te ndikoje ne vleren dhe te drejtat qe do te gezoje Fondi si zoterues i ketyre aksioneve te reja.

c. Shlyerja e Vleres se Aksioneve te Reja

Nese Fondi vendos te nenshkruaje Aksionet e Reja te Fazes se Pare, Fondi do te depozitoje Vleren e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, ne shumen US$ 292.208 (dy qind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tete dollare US)), menjhere pas Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, ne nje llogari bankare "*escrow*" te veçante ne emer te Shoqerise e te Fondit (dhe nga ku mund te terhiqen vetem me firme te perbashket te Fondit dhe te perfaqesuesit te Shoqerise). Kjo shume do te jete e disbursueshme menjehere pas marrjes se vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per njohjen e zmadhimit te Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit nga emetimi i Aksioneve te Reja te Fazes se Pare dhe hyrjen e Fondit ne Shoqeri si aksionar qe zoteron Aksionet te Reja te Fazes se Pare.

SEKSIONI 2.01.

Deklarime dhe Garanci.

Aksionaret dhe Shoqeria deklarojne dhe garantojne Fondin se:

(i) Shoqeria eshte nje shoqeri anonime e krijuar rregullisht, e cila eshte ne gjendje te mire dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqeria eshte rregullisht e liçencuar dhe e autorizuar nepermjet te gjitha çertifikatave, liçensave dhe lejeve te aplikueshme afati i te cilave aktualisht nuk ka skaduar, per te zhvilluar aktivitetin e saj ekonomik ne menyren qe eshte duke e zhvilluar aktualisht. Shoqeria gezon zotesi te plote juridike per te vepruar, per te patur ne pronesi dhe per te zoteruar pasurite e saj dhe te zhvilloje aktivitetin e saj ekonomik ne menyren si po e zhvillon aktualisht. Aksionaret jane pronare te ligjshem te aksioneve te Kapitalit te Shoqerise, te cilat jane te regjistruar ne menyre te rregullt ne Regjistrin Tregtar dhe jane te lira nga çdo barre siguruese, peng, barre tjeter kufizuese, apo çdo e drejte tjeter ne favor te ndonje te treti.

(ii) Aksionet e reja qe jane emetuar dhe/ose qe do te emetohen ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj Marreveshje, jane dhe/ose do te jene rregullisht e vlefshmerisht te emetuara dhe nuk jane dhe/ose nuk do te jene objekt i te drejtes se perparesise se nenshkrimit ose i ndonje te drejte tjeter te Aksionareve e cila rrjedh nga ligji apo Statuti i Shoqerise, si dhe jane dhe/ose do te jene te lira nga çdo barre siguruese, peng, barre tjeter kufizuese, apo çdo e drejte tjeter ne favor te ndonje te treti. Gjithashtu Aksionaret dhe Shoqeria marrin persiper qe te mos zvogelojne Kapitalin e Shoqerise apo te kryejne ndonje operacion tjeter qe mund te ndikoje ne vleren dhe te drejtat qe do te gezoje Fondi si zoterues i ketyre aksioneve te reja sipas kesaj Marreveshje.

(iii) Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Marreveshje dhe çdo Dokumenti Transaksioni nuk perben shkelje te ndonje ligji, akti nenligjor, Statutit te Shoqerise apo te ndonje klauzole te ndonje marreveshje detyrimi apo marreveshjeje tjeter ne te cilen ndonje Aksionar apo Shoqeria eshte pale, dhe nuk do te shkaktoje ndonje mospermbushje sipas ketyre marreveshjeve. Kjo Marreveshje eshte nenshkruar rregullisht dhe perben, ashtu si çdo Dokument Transaksioni, marreveshje te ligjshme e te detyrueshme per Aksionaret dhe Shoqerine, dhe te ekzekutueshme

kundrejt Aksionareve dhe Shoqerise sipas kushteve dhe afateve te parashikuara ne te.

(iv) Asnje veprim, miratim ose aprovim i ndonje Autoriteti Publik nuk eshte i nevojshem ne lidhje me transaksionet objekt i kesaj Marreveshje apo i Dokumenteve te Transaksionit, me perjashtim te atyre qe jane bere me pare dhe jane ne fuqi.

(v) Nuk ka asnje person fizik ose juridik qe posedon, ose u njihet nga Aksionaret, e drejta per te poseduar aksione te kapitalit te Shoqerise dhe nuk eshte autorizuar e nuk ekziston aktualisht asnje marreveshje, garanci, premtim per shit-blerje te aksioneve te Kapitalit te Shoqerise, marreveshje per konvertimin e borxheve ne aksione ose ne ndonje te drejte tjeter (indirekt ose ndryshe). Perveç rasteve te percaktuara ne kete Marreveshje, Aksionaret dhe/ose Shoqeria nuk kane detyrime (indirekte ose ndryshe) per te emetuar, blere, shitur, apo te disponojne ne çdo menyre tjeter ndonje pjese te aksioneve te kapitalit te Shoqerise apo te drejtave mbi to ose te paguaje ose te shperndaje ne ndonje menyre tjeter dividente.

(vi) Nuk ka asnje proces ligjor qe te kete filluar apo qe mund te filloje kunder Shoqerise qe te mund te cenojne materialisht aktivitetin e saj ekonomik.

(vii) Ne mjediset e Shoqerise nuk ka mbetje ose substanca te rrezikshme.

(viii) Shoqeria nuk ka detyrime te ditura ose te paditura, direkte ose indirekte, te rrjedhura nga legjislacioni ne fuqi ose rregulloret per mbrojtjen e shendetit te njerezve dhe mjedisit.

(ix) Asnje klient ose furnitor prej te cileve vijne me shume se 10% e te ardhurave bruto te Shoqerise gjate periudhes se pasqyruar nga raportet financiare per vitin financiar 2002, nuk ka perfunduar apo pakesuar ne menyre te ndjeshme ose kercenuar per te perfunduar ose paksuar menyre te ndjeshme blerjet e ose furnizimet me produkte ose sherbimeve te Shoqerise.

(x) As kjo Marreveshje, as Dokumentet e Transaksionit, as marreveshje te lidhura me te, nuk permbajne deklarata te paverteta, as nuk lene pa permendur fakte te rendesishme te nevojshem per te bere deklaratat qe permbajne keto dokumente, ne driten e rrethanave nen te cilat ato jane bere, as nuk permbajne deklarata çorientuese. Nuk ka fakt, per te cilin Aksionaret jane ose duhet te jene ne dijeni, qe ndikon ose mund te ndikoje ne menyre te ndjeshme dhe negativisht veprimtarine ekonomike te Shoqerise, qe Aksionaret nuk ia ka bere te ditur Fondit me shkrim.

SEKSIONI 3.01.

<u>Kushtet e Nenshkrimit dhe Shlyerjes se Aksioneve te Reja</u>

a. Permbushja e te drejtes se Fondit per te nenshkruar aksionet e reja ne Daten e Nenshkrimit te Aksioneve te Fazes se Pare e te Dyte, kushtezohet nga plotesimi kushteve te meposhtme:

(i) Fondi dhe keshilltari i tij ligjor duhet te marrin kopje te Dokumenteve Ligjore te Shoqerise, Dokumentet e Transaksionit te nenshkruara rregullisht, dhe te tjera dokumente mbeshtetese te cilat keshilltari ligjor i Fondit kerkon ne menyre te arsyetuar, ne çdo rast ne formen dhe te vertetuara ne menyre e kerkuar nga keshilltari i Fondit;

(ii) Fondi duhet te marre mendimin e keshilltarit te tij ligjor ne lidhje me deklarimet dhe garancite e percaktuara ne Seksionin 2.01 (ii) dhe (v), (nenkuptohet qe keshilltari ligjor i Fondit mund te mbeshtetet ne nje deklarate te Drejtorit te Shoqerise per ekzistencen e marreveshjeve ne te cilat Aksionaret apo Shoqeria eshte pale);

(iii) Deklarimet dhe garancite e percaktuara ne Seksionin 2.01 me siper jane te verteta dhe korrekte sot dhe do te jene te verteta edhe ne Daten e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare e te Dyte dhe me te njejten fuqi si te ishin bere sot;

(iv) Aksionaret dhe Shoqeria duhet te veproje ne perputhje me te gjitha kushtet dhe dispozitat e percaktuara ne kete Marreveshje dhe ne Dokumentet e tjera te Transaksionit, dhe Fondit duhet t'i dergohet nje dokument i pergatitur nga Drejtori i Shoqerise i cili konfirmon pajtimin me kete paragraf (iv) dhe paragrafin (iii) me siper;

(v) Te gjitha miratimet dhe aprovimet e Aksionareve, Autoriteteve Publike, dhe gjithe te treteve qe jane te detyruar te zbatojne transaksionet e percaktuara nga kjo Marreveshje dhe Dokumentet e tjera te Transaksionit, duhet te behen ne forme, kufij dhe permbajtje te pranueshme nga Fondi dhe duhet te jene ne fuqi ne Daten e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare e te Dyte;

(vi) Ne Daten e Nenshkrimit te Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise duhet te jete mbledhur dhe te kete aprovuar: 1) emetimin e Aksioneve te Reja te Kapitalit te Shoqerise dhe nenshkrimin e shlyerjen e tyre nga Fondi; 2) emerimin ne detyren e anetarit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise te tre personave, njeri i caktuar nga Aksionaret, nje nga punonjesit e Shoqerise dhe nje nga Fondi, me kusht qe ky Keshill te perbehet nga tre anetare dhe te marre vendime me unanimitet te te gjithe anetareve; 3) ndryshimin e Statutit te Shoqerise, duke parashikuar se pavaresisht nga minimumi i numrit te votave qe kerkohet sipas Statutit apo ligjit, vendimet e Asamblese se Aksionareve mbi Vendimet Strategjike, emerimi dhe shkarkimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres, si dhe ato per shitjen apo blerjen e aseteve te Shoqerise me vlere me te madhe se US$ 5.000 (pese mije dollare US), do te jene te vlefshme vetem me pelqimin e Fondit. Po ashtu Drejtori i Finances duhet te marre nje vleresim te pranueshem nga nje prej shoqerive te njohura te auditimit te pranuara nga Fondi. Po ashtu çdo propozim per emerime apo ndryshime ne strukturen organizative te Shoqerise duhet te diskutohet dhe konsultohet nga ana e Shoqerise me Fondin;

(vii) Fondi ka te drejte te dergoje prane Shoqerise, here pas here persona te autorizuar

prej tij per te kontrolluar aktivitetin e Shoqerise. Personat e autorizuar nga Fondi duhet te ruajne konfidencialitetin per çdo informacion qe marrin prane Shoqerise gjate ushtrimit te kontrollit, me perjashtim te rasteve kur dhenia e deklarimi i ketij informacioni kerkohet nga ligji;

(viii) Te gjitha problemet juridike lidhur me transaksionet objekt i kesaj Marreveshje do te zgjidhen ne menyren e sygjeruar nga keshilltari ligjor i Fondit;

(ix) Brenda gjashte muajve kalendarike nga data e nenshkrimit te kesaj Marreveshje Aksionaret dhe Fondi te kene miratuar Planin e Investimit.

(x) Te jete permbushur kushti i parashikuar ne paragrafin (iii) te Seksionit 5.01 me poshte.

b. Do te konsiderohet se Fondi ka vendosur te nenshkruaje Aksionet e Fazes se Pare pasi Fondi te kete njoftuar me shkrim Shoqerine brenda gjashte muajve nga data e nenshkrimit te kesaj Marreveshje. Permbushja nga ana e Fondit e detyrimit per te shlyer Vleren e Aksioneve te Reja te Fazes se Pare, kerkon permbushjen e kushteve te meposhtme ne daten e kryerjes se pageses per te cilen Aksionaret, Shoqeria dhe Fondi kane rene dakord:

(i) deklarimet dhe garancite e percaktuara ne Seksionin 2.01 me siper jane te verteta dhe korrekte sot dhe do te jene te verteta edhe ne daten e kryerjes se ketyre pagesave dhe me te njejten fuqi qe kane sot;

(ii) Aksionaret dhe Shoqeria duhet te veprojne ne perputhje me te gjitha kushtet dhe dispozitat e percaktuara ne kete Marreveshje dhe ne Dokumentet e tjera te Transaksionit.

SEKSIONI 4.01.

Marreveshje.

(i) Aksionaret duhet t'i dorezojne Fondit nje orgjinal te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne lidhje me depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te Asamblese se Aksionareve per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise, ndryshimet perkatese ne Statutin e Shoqerise, pjesemarrjen e Fondit ne kapitalin e Shoqerise si dhe ato qe parashikohen ne paragrafin (a.vi) te Seksionit 3.01.

(ii) Aksionaret dhe Shoqeria bien dakord qe Shoqeria t'i paguaje Fondit ne momentin e nenshkrimit te kesaj Marreveshje shumen US$ 7,000 (shtate mije dallare US) si pagese angazhimi. Shoqeria do te kryeje pagesen e kesaj shume ne US$ (dollare US) me çek ose transferte bankare ne llogarine bankare te Fondit prane Bankes Amerikane te Shqiperise, Tirane, Shqiperi, ne fonde menjehere te vlefshme. Pagesa e komisioneve bankare nuk perfshihet ne shumen e siperpermendur.

SEKSIONI 5.01.

E Drejta per te Shitur Aksionet

(i) Aksionaret marrin persiper ne menyre te parevokueshme, qe ne proporcion me numrin e aksioneve qe zoterojne ne kapitalin e Shoqerise, te blejne nga Fondi, ne çdo kohe pas kalimit te dy vjeteve nga data e vendimit te Gjykates te permendur ne paragrafin (c.i) te Seksionit 1.01, dhe me kerkesen e Fondit, te gjitha apo nje pjese te aksioneve qe do te zoterohen nga Fondi ne Kapitalin e Shoqerise ne daten e shitjes ("Aksionet e Fondit") me kusht qe Fondi te njoftoje Aksionaret te pakten gjashte muaj perpara, kundrejt çmimit te shitjes ("Çmimi i Shitjes") te percaktuar sipas formules se meposhtme:

7 here EBITDA per ate vit dhe EBITDA-ne e vitit paraardhes

E drejta e Fondit qe t'i shese Aksionareve te gjitha apo nje pjese te Aksioneve te Fondit ne Kapitalin e Shoqerise, te ciles i pergjigjet detyrimi i marre persiper nga Aksionaret per te bleje keto aksione, quhet e "Drejta per te Shitur Aksionet".

(ii) Nese ndonje nga Aksionaret nuk eshte ne gjendje t'i paguaje Fondit menjehere te gjithe Çmimin e Shitjes, ai Aksionar do ta paguaje ate si hua te kthyeshme per 3 vjet me interes vjetor 10%. Aksionaret do te garantoje Fondin per ushtrimin e te Drejtes per te Shitur Aksionet qofshin keto te Fazes se Pare dhe/ose te Fazes se Dyte, dhe pagimin e Çmimit te Shitjes, duke lene peng ne favor te Fondit te gjitha aksionet e tyre ne Kapitalin e Shoqerise.

(iii) Ushtrimi i te Drejtes per te Shitur Aksionet dhe pagesa e Çmimit te Shitjes do te rregullohet nepermjet Marreveshjes per Shitjen e Aksioneve e cila do te nenshkruhet se bashku me Marreveshjen e Pengut mbi Aksionet [paragrafi (ii) me siper] midis Aksionareve dhe Fondit ne Daten e Nenshkrimit te Aksioneve te Fazes se Pare.

Seksioni 6.01

Te ndryshme

(i) Kjo Marreveshje dhe Dokumentet e tjera te Transaksionit perbejne te gjithe marreveshjen e arritur midis Paleve ne lidhje me çeshtjet objekt i kesaj Marreveshje. Çdo marreveshje e mepareshme ndermjet Paleve ne lidhje me transaksionet qe jane objekte te kesaj Marreveshje Investimi do te zevendesohet me kete Marreveshje dhe Dokumentet e tjera te Transaksionit. Asgje ne kete Marreveshje ose ne Dokumentet e tjera te Transaksionit, e shprehur ose nenkuptuar, nuk ka qellim t'ia kaloje ndonje pale tjeter, te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne kete Marreveshje.

(ii) Ne rast se ndonje apo me shume dispozita te kesaj Marreveshje dhe dokumenteve te tjera te Transaksionit do te shpallen apo konsiderohen te pavlefshme, te paligjshme ose te pazbatueshme, vlefshmeria, ligjshmeria apo zbatueshmeria e dispozitave qe mbeten nuk do te ndikohet. Palet ne mirebesim do te negociojne per te zevendesuar dispozitat e pavlefshme, te kundraligjshme ose te paekzekutueshme me dispozita te vlefshme me efekt ekonomik sa me te perafert me ato te pavlefshmet, kundraligjshmet dhe te paekzekutueshme.

(iii) Nese Fondi vendos to mos ushtroje ose nuk nuk e ushtron brenda afatit te drejten per te nenshkruar Aksionet e Reja te Fazes se Pare siç parashikohet me siper ne paragrafin (a) te

